# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5510
E martë, 26 qershor 2018
çmimi 0.40 €

## Pacolli nis turneun diplomatik në Afrikë, lobon për njohje të reja



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de



FLET PËR "EPOKËN E RE", KADRI KASTRATI FAQE 4-5

# Formimi i ushtrisë po vonohet

Ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Kadri Kastrati, ka bërë me dije se Kosova po vonohet shumë për formimin e ushtrisë së vet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se këto vonesa shkaktojnë edhe humbje në aspektin e sigurisë. Kastrati ka ftuar institucionet e Kosovës që brenda këtij viti me anë të ligjit t'ia ndryshojnë mandatin FSK-së. Sipas ish-komandantit të FSK-së, kjo duhet të ndodhë duke ua bërë të qartë partnerëve strategjikë se kjo është e vetmja rrugë për formimin e ushtrisë ngaqë përfaqësuesit e komunitetit serb vazhdimisht po deklarojnë se nuk do t'i votojnë ndryshimet e nevojshme kushtetuese për këtë çështje

PARTITË OPOZITARE NUK E MBËSHTESIN PRESIDENTIN HASHIM THAÇI PËR TË DIALOGUAR ME SERBINË

## Opozita nuk e dëshiron presidentin Thaçi në krye të dialogut



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV) kanë bërë me dije se nuk e përkrahin presidentin Hashim Thaçi për ta udhëhequr dialogun me Serbinë. Përfaqësuesit e dy partive opozitare kanë thënë se Thaçi nuk ka asnjë autorizim për të negociuar në emër të qytetarëve të Kosovës. Kështu që, sipas tyre, çdo marrëveshje që arrihet në Bruksel mund të jetë vetëm marrëveshje private e Thaçit, por jo në emër të Kosovës FAQE 7



## Rreziqet që u shkakton fëmijëve përdorimi i tepërt i internetit FAQE 6

Përdorimi i internetit dhe teknologjisë sot është një nga trendët e përhapur në gjithë botën. Por, sikurse në shumë vende të tjera, edhe në Kosovë shqetësues mbetet përdorimi i tepërt dhe i pakontrolluar i internetit nga fëmijët

## AKTUALE

DIPLOMOI GJENERATA 2018 E KADETËVE TË FSK-së F. 2

HARADINAJ: TA KTHEJMË BESIMIN NË INSTITUCIONE F. 7

KËRKOHET ANGAZHIM MAKSIMAL PËR REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË BE-SË F. 7

## EKONOMI

ABDIXHIKU PROPOZON QË INSTITUCIONET MIKROFINANCIARE T'IA KTHEJNË FITIMIN SHTETIT F. 9

PAGAT E TRUSTIT NIVELOHEN ME ATO TË BQK-së F. 9

## KULTURË

XHIRIMET KRYESORE TË FILMIT "SHPATA PREJ DRURI" DO TË BËHEN NË QYTETIN E MITROVICËS F. 10

DUKAGJINËT SIPAS BURIMEVE ARKIVORE TË DUBROVNIKUT NË SHEKULLIN XIV F. 11
Prof. dr. Musa AHMETI

## SPORT

FIFA DËNON XHAKËN DHE SHAQIRIN ME TË HOLLA F. 17

URUGUAI POSHTËRON RUSINË NË RUSI F. 16

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
Mob.: +377(0) 44 506 815
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Delawie kërkon nga Kuvendi t'i emërojë tre gjyqtarë të Kushtetueses



PRISHTINË, 25 QERSHOR - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Greg Delawie, ka kërkuar nga Kuvendi i Kosovës që sa më parë t'i emërojë tre gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë kontekst, ai ka thënë se politika nuk ka vend në këtë gjykatë. "Politika nuk ka vend në Kushtetutë. Nuk bën të ketë më vonesa: Kuvendi duhet të emërojë menjëherë tre gjyqtarë të kualifikuar të Gjykatës Kushtetuese. Gjykata më e lartë themelore e Kosovës mund të funksionojë dhe ta mbrojë sundimin e ligjit", ka shkruar Delawie në llogarinë e vet në "Twitter". Para disa javësh Kuvendi i Kosovës ka dështuar të emërojë tre gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese nga komuniteti shumicë.

# Diplomoi gjenerata 2018 e kadetëve të FSK-së

Ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, në ceremoninë e zhvilluar në Ferizaj ka thënë se gradimi i kadetëve në oficerë të FSK-së po bëhet në një fazë shumë të rëndësishme të zhvillimit të FSK-së, kur edhe pritet që kjo Forcë t'i avancojë kapacitetet operacionale dhe ta ndryshojë misionin e saj. "Ky standard i arritur është një shembull i qartë i zhvillimit dhe progresit që po e bën FSK-ja me profesionalizëm dhe në arritje të standardeve më të larta ushtarake të NATO-s", ka thënë ministri Berisha



FERIZAJ, 25 QERSHOR (ER) - Në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ferizaj u zhvillua ceremonia e diplomimit të kadetëve "Gjenerata 2018" të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së. Pas diplomimit, me gradë nëntogeri u graduan gjithsejtë 11 oficerë të rinj të cilët me sukses mbaruan shkollimin katërvjeçar për udhëheqje në Qendrën për Studime Universitare dhe atë akademik në Universitetin Amerikan në Prishtinë.

Ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, ka thënë se sot është ditë e veçantë për FSK-në, por edhe për atë si ministër, për faktin se në këtë ceremoni po diplomojnë dhe po gradohen 11 kadetë të "Gjeneratës 2018" të QSU-së të FSK-së. "Gjatë kësaj periudhe katërvjeçare ju keni kaluar nëpër sfida të shumta të cilat, falë punës, angazhimit dhe vendosmërisë, ju i keni përfunduar me sukses dhe nga sot po gradoheni me gradën e nëntogerit. Gradimi juaj në oficerë të FSK-së po bëhet në një fazë shumë të rëndësishme të zhvillimit të FSK-së, kur edhe pritet që kjo Forcë t'i avancojë kapacitetet operacionale dhe ta ndryshojë misionin e saj. Ky standard i arritur është një shembull i qartë i zhvillimit dhe progresit që po e bën FSK-ja me profesionalizëm dhe me arritje të standardeve më të larta ushtarake të NATO-s", ka thënë ministri Berisha.

Në fund të fjalës së tij, ministri Rrustem Berisha iu drejtua kadetëve me këto fjalë: "Të dashur kadetë, nuk ka mision më të shenjtë sesa kontributi për vlerat e lirisë dhe sigurisë, andaj ju dëshiroj suksese në këtë rrugëtim, po ashtu një falënderim i veçantë edhe për familjet e juaja të cilat ju kanë qëndruar dhe mbështetur në vazhdimësi".

# Pacolli nis turneun diplomatik në Afrikë, lobon për njohje të reja



PRISHTINË, 25 QERSHOR - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka nisur turneun diplomatik në Afrikë. Njohjet e reja dhe anëtarësimi në INTERPOL do të jenë temat kryesore të kësaj vizite. "Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka nisur turin e ri diplomatik në kontinentin afrikan, ku pritet të takohet me presidentë, ministra të jashtëm dhe përfaqësues të tjerë të shteteve të ndryshme nga ky kontinent. Në kuadër të kësaj vizite, kryediplomati kosovar synon shtimin e njohjeve të reja, zgjerimin e përkrahjes për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në INTERPOL si dhe forcimin e marrëdhënieve bilaterale", është thënë në komunikatën e Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ).

Vizita në kontinentin afrikan pason pas turneut diplomatik që ministri Pacolli zhvilloi gjatë javës së kaluar në disa shtete anëtare të Bashkimit Evropian dhe shtete të tjera të Evropës.

LAJME SHKURT

## Mogherini: Negociatat për Shqipërinë, vendim i drejtë

TIRANË, 25 QERSHOR - Përfaqësuesja e Lartë për Politikën e Jashtme të BE-së, Federica Mogherini, u shpreh se hapja e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë dhe Maqedonisë është vendim i drejtë dhe në interes të dyanshëm. Ministri Bushati falënderoi vendet anëtare për mbështetjen e vazhdueshme e të pakursyer në perspektivën evropiane të Shqipërisë dhe u shpreh se ky takim është një mundësi shumë e mirë për të diskutuar për progresin e bërë. Ministri Bushati nënvizoi hapat që ka ndërmarrë Shqipëria përmes reformave të guximshme për ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe plotësimin e pesë prioriteteve në kuadrin e perspektivës së anëtarësimit në BE.

Në takim u diskutua mbi koordinimin e hapave të mëtejshme të fillimit të bisedimeve të anëtarësimit. Në këtë kontekst, ministrat e jashtëm të vendeve anëtare vlerësuan rolin konstruktiv të Shqipërisë në rajon dhe rezultatet pozitive të arritura në përmbushje të prioriteteve kyçe për çeljen e negociatave të anëtarësimit dhe miratimin e reformës në drejtësi, duke theksuar rëndësinë e zbatimit të qëndrueshëm të tyre. Gjithashtu, ata nënvizuan progresin e pasqyruar në Raportin e Komisionit duke evidentuar ecurinë e reformave shtet-konsoliduese dhe çmuar vendosmërinë e Qeverisë shqiptare për ta vijuar zbatimin e reformës në drejtësi.

## Basha: BE-ja ka vendosur kundër negociatave për Shqipërinë

TIRANË, 25 QERSHOR - Kur na ndajnë vetëm pak ditë nga vendimi final për hapjen ose jo të negociatave për Shqipërinë, kreu i opozitës, Lulzim Basha, jep një lajm që, nëse do të jetë me burime të sigurta, do të shkaktojë reagime të forta. Ai u shpreh të hënën për mediet se vendet e BE-së kanë vendosur ta refuzojnë hapjen e negociatave me Shqipërinë. Sipas tij, me gjithë dëshirën e shqiptarëve dhe përpjekjes së opozitës, Bashkimi Evropian vendos këtë javë që Shqipëria nuk i ka plotësuar kushtet. "Kjo është gjëma që ka ndërtuar Edi Rama në Shqipëri, kjo është arsyeja pse këtë javë Bashkimi Evropian, pavarësisht prej dëshirës së 97 % të shqiptarëve, punës që kemi bërë ne si opozitë, prapëseprapë vendos që Shqipëria nuk i ka plotësuar kushtet sepse kushti themelor është të ndërtojë një shtet të së drejtës dhe jo një shtet të drogës, jo një narkoshtet. Kushti themelor është të ndërtojë një ekonomi me shanse të barabarta për të gjithë dhe jo një ekonomi të parave të pista të drogës, ku pesë banda kriminale dhe pesë oligarkë kontrollojnë të gjithë ekonominë. Biznesi i vogël dhe i mesëm është në kolaps, profesionistët janë në arrati, mediet të kapura dhe rinia e pashpresë", ka thënë Basha.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Partitë opozitare nuk e mbështesin presidentin Hashim Thaçi për të dialoguar me Serbinë

# Opozita nuk e dëshiron presidentin Thaçi në krye të dialogut



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV) kanë bërë me dije se nuk e përkrahin presidentin Hashim Thaçi për ta udhëhequr dialogun me Serbinë. Përfaqësuesit e dy partive opozitare kanë thënë se Thaçi nuk ka asnjë autorizim për të negociuar në emër të qytetarëve të Kosovës. Kështu që, sipas tyre, çdo marrëveshje që arrihet në Bruksel mund të jetë vetëm marrëveshje private e Thaçit, por jo në emër të Kosovës

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Shefja e politikës së jashtme e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, ka thënë të hënën se takimi i fundit në mes të presidentëve të Kosovës dhe Serbisë, Hashim Thaçi dhe Aleksandër Vuçiq, në kuadër të dialogut ka qenë i vështirë, por inkurajues. "Të dielën kemi pasur një takim shumë të mirë midis Beogradit dhe Prishtinës, i cili u zhvillua në mënyrë inkurajuese, por ishte shumë i vështirë", ka thënë Mogherini. Por, pavarësisht prej vështirësive të vazhdimit të këtij dialogu, presidenti i vendit, Hashim Thaçi, nuk do ta ketë përkrahjen e opozitës për t'i udhëhequr bisedimet me Serbinë. Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë të hënën se dialogu është e vetmja rrugë për t'i zgjidhur çështjet me Serbinë por, sipas tij, presidenti Thaçi nuk ka asnjë autorizim për të negociuar në emër të qytetarëve të Kosovës. "Ne besojmë se dialogu është e vetmja rrugë për t'i zgjidhur çështjet me fqinjën tonë veriore, Serbinë. Dëshirojmë ta përshëndesim angazhimin e miqve tanë ndërkombëtarë në këtë proces, BE-në dhe ShBA-së. Sipas Kushtetutës, Kuvendi i Kosovës është organi i vetëm që vendos se kush e përfaqëson Kosovën në dialog me Serbinë. Kuvendi i Kosovës nuk ka vendosur ende për këtë çështje, pasi platforma për dialog me Serbinë, që ishte në rend ditë në Kuvend, u tërhoq nga Qeveria. Ndërkaq platforma e vitit 2011 e autorizon Qeverinë të dialogojë me Serbinë. Rrjedhimisht, presidenti Thaçi nuk ka asnjë autorizim për të negociuar në emër të qytetarëve të Kosovës", është shprehur Hoti në një konferencë për medie.

Ai ka bërë me dije se LDK-ja nuk e mbështet presidentin që ta zhvillojë dialogun me Serbinë, pasi që, sipas Hotit, Thaçi nuk e përfaqëson vullnetin politik të Kosovës. "Kështu që, çdo marrëveshje që arrihet në Bruksel mund të jetë vetëm marrëveshje e tij private, por jo në emër të Kosovës. LDK-ja, si partia kryesore në vend, është e gatshme të marrë përsipër këtë proces të rëndësishëm për të ardhmen e vendit. Këtë përgjegjësi ne do ta marrim përmes votës së qytetarëve në zgjedhje të lira", ka deklaruar Hoti.

Edhe Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka kundërshtuar udhëheqjen e dialogut nga presidenti Hashim Thaçi. Deputetja e kësaj lëvizje, Albulena Haxhiu, ka thënë se ky proces ishte ndërtuar mbi premisa të gabuara. Sipas saj, presidenti Hashim Thaçi në takime me presidentin serb Aleksandar Vuçiq nuk e përfaqëson shtetin e Kosovës, por veten. "Thaçi në takim me (Aleksandar) Vuçiqin nuk përfaqëson Kosovën. Ai veç veten mund të përfaqësojë atje. Kosovës i duhet një bilanc. Duhet një pasqyrë e plotë për marrëveshjet nga energjia te telekomunikacioni, nga liria e lëvizjes te njohja e diplomave, nga policia e gjyqësia në veri te përfaqësimi diplomatik i ndërsjellë, nga menaxhimi i përbashkët i kufirit deri te denominimi antikushtetues i Republikës së Kosovës (fusnota). Hashim Thaçi duhet të ndalet. Askush nuk mund të pranojë dëme të reja për avazet e tij", ka thënë deputetja Haxhiu.

Ajo ka theksuar se nuk mund të vazhdohet një fazë e re e dialogut pa e pasur një vlerësim për procesin e deritanishëm. "Ne nuk mund të vazhdojmë në një fazë të re të dialogut pa e pasur një vlerësim për dialogun, pa vendosur se me çfarë korniza do të paraqitemi në marrëdhëniet e tilla dhe se çfarë do të fitojë Kosova prej proceseve të tilla", është shprehur Haxhiu.

## KDI-ja: Thaçi ta informojë Kuvendin për procesin e dialogut

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka kërkuar nga presidenti Hashim Thaçi t'i drejtohet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe t'i informojë deputetët rreth përmbajtjes së bisedimeve dhe hapave të mëtutjeshëm të procesit të dialogut. Sipas KDI-së, ende nuk është e qartë se çfarë do të përmbajë faza finale e dialogut, cilat tema do të jenë pjesë e këtyre diskutimeve si dhe çfarë pritet të arrihet në përfundim të tij. "Pas takimit të së dielës në Bruksel ndërmjet presidentëve të Kosovës dhe Serbisë, kreu i shtetit të Kosovës, Hashim Thaçi, duhet t'i drejtohet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe t'i informojë deputetët rreth përmbajtjes së bisedimeve dhe për hapat e mëtutjeshëm të këtij procesi për të cilat është dakorduar në takimin e mbajtur. Procesi i dialogut vazhdon të jetë jotransparent. Ende nuk është e qartë se çfarë do të përmbajë faza finale e dialogut, cilat tema do të jenë pjesë e këtyre diskutimeve, çfarë pritet të arrihet në përfundim të tij dhe si do të garantohet gjithëpërfshirja politike dhe respektimi i mandatit kushtetues të institucioneve të vendit", është thënë në këtë komunikatë. KDI-ja ka vlerësuar se është jetike për vendin që faza finale e dialogut ta garantojë gjithëpërfshirjen politike. Ky institut ka kërkuar që institucionet shtetërore t'i kryejnë obligimet kushtetuese dhe ta respektojnë komunikimin në kuadër të kompetencave institucionale, me qëllimin e vetëm për ta mbrojtur interesin shtetëror dhe jo për ta minuar atë. "Kuvendi i Kosovës që nga konstituimi i tij nuk ka mbajtur asnjë seancë me pikë të rendit të ditës të ardhmen e dialogut Kosovë - Serbi. Kuvendi nuk ka më kohë për të humbur për ta miratuar rezolutën për të ardhmen e këtij procesi", është theksuar më tutje në komunikatë. Sipas KDI-së, Kuvendi i Kosovës duhet të marrë përgjegjësi në procesin e dialogut, duke definuar pritshmëritë dhe vijat e kuqe të shtetit. "Institucionet e Kosovës nuk duhet të lejojnë që bisedimet me Serbinë të vazhdojnë pa arritjen e një konsensusi politik dhe pa platformë shtetërore. KDI-ja u bënë thirrje edhe partive politike të angazhohen për këtë proces shtetëror duke luajtur një rol më konstruktiv dhe më të përgjegjshëm, duke lënë mënjanë politikat ditore dhe kalkulimet politike", është thënë në komunikatën e KDI-së.

Flet për "Epokën e re", Kadri Kastrati

# Formimi i ushtrisë



Ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Kadri Kastrati, ka bërë me dije se Kosova po vonohet shumë për formimin e ushtrisë së vet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se këto vonesa shkaktojnë edhe humbje në aspektin e sigurisë. Kastrati ka ftuar institucionet e Kosovës që brenda këtij viti me anë të ligjit t'ia ndryshojnë mandatin FSK-së. Sipas ish-komandantit të FSK-së, kjo duhet të ndodhë duke ua bërë të qartë partnerëve strategjikë se kjo është e vetmja rrugë për formimin e ushtrisë ngaqë përfaqësuesit e komunitetit serb vazhdimisht po deklarojnë se nuk do t'i votojnë ndryshimet e nevojshme kushtetuese për këtë çështje

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

**Prishtinë, 25 qershor** - Ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Kadri Kastrati, ka paralajmëruar institucionet e Kosovës se po vonohen me formimin e ushtrisë. Ai i ka bërë thirrje Qeverisë dhe Kuvendit që sa më shpejt me anë të ligjit t'i ndryshohet mandati FSK-së meqenëse themelimi i Forcave të Armatosura me anë të ndryshimeve kushtetuese po shihet si rrugë e pamundur. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se formimi i ushtrisë është çështje e brendshëm e Kosovës dhe këtë të drejtë nuk mund t'ia mohojë askush. "Jam shumë i bindur se dita-ditës Kosova po vonohet shumë në formimin e ushtrisë. Kam thënë edhe më herët dhe po e përsëris prapë, se Qeveria, së bashku me Kuvendin e Kosovës, duhet të ecin tutje në këtë drejtim dhe të mos vonohen më. Me marrëveshje me partnerët tanë strategjikë, institucionet tona duhet të fillojnë që me anë të ligjit FSK-së t'ia ndryshojnë mandatin dhe të vazhdohet tutje me këtë proces", ka thënë Kastrati.

Ai ka treguar se sa po humbet Kosova me vonesat në formimin e ushtrisë. "Kosova po humbet me këto vonesa, sepse për ta bërë një ushtri operacionale duhen rreth 10 vjet kohë. Pra, ushtria nuk mund të bëhet brenda një kohe të shkurtër. Prandaj po them që sa më herët të fillohet të veprohet në këtë drejtim është më mirë. Në këtë drejtim Kosova po humbet në aspektin e sigurisë, në aspektin e integrimit në NATO, si dhe në aspektin e integrimeve rajonale dhe anëtarësimin në mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë", ka thënë Kastrati.

Ish-komandanti i FSK-së ka vlerësuar se Kosova nuk ka asnjë arsye të vonohet në këtë drejtim. Sipas tij, institucionet e Kosovës këtë vit duhet të marrin vendim për ndryshimin e mandatit të FSK-së.

**"Epoka e re":** *Z. Kastrati, me gjithë paralajmërimet e shumta të Qeverisë, se do të procedojë transformimin e FSK-së, ende nuk është marrë ndonjë veprim. A po vonohen institucionet e Kosovës në formimin e ushtrisë?*

**Kastrati:** Jam shumë i bindur se dita-ditës Kosova po vonohet shumë në formimin e ushtrisë. Kam thënë edhe më herët dhe po e përsëris prapë se Qeveria, së bashku me Kuvendin e Kosovës, duhet të ecin tutje në këtë drejtim dhe të mos vonohen më. Me marrëveshje me partnerët tanë strategjikë, institucionet tona duhet të fillojnë që me anë të Ligjit FSK-së t'ia ndryshojnë mandatin dhe të vazhdohet tutje me këtë proces.

**"Epoka e re":** *Sa po humbet Kosova me këto vonesa?*

**Kastrati:** Natyrisht se Kosova po humbet me këto vonesa, sepse për ta bërë një ushtri operacionale duhen rreth 10 vjet kohë. Pra, ushtria nuk mund të bëhet brenda një kohe të shkurtër. Prandaj po them që sa më herët të fillohet të veprohet në këtë drejtim është më mirë. Në këtë drejtim Kosova po humbet në aspektin e sigurisë, në aspektin e integrimit në NATO, si dhe në aspektin e integrimeve rajonale dhe anëtarësimin në mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë.

Unë nuk po shoh ndonjë arsye pse po shtyhet kaq shumë ky proces kur vazhdimisht po shihen qëndrimet e përfaqësuesve serbë të Kosovës se ata nuk do ta përkrahin formimin e ushtrisë së Kosovës. Duke u nisur nga këto deklarime, ne duhet t'ia bëjmë të qartë faktorit ndërkombëtar dhe partnerëve tanë strategjikë, se Kosova nuk mund t'i presë deri në pafundësi përfaqësuesit e komunitetit serb, sepse formimi i ushtrisë është nevojë e Kosovës. Edhe partnerët tanë duhet ta kuptojnë se ne si shtet i pavarur dhe sovran e kemi të drejtën që ta kemi ushtrinë tonë, kjo është çështje e brendshme e Kosovës dhe këtu askujt nuk duhet t'i mbetet hatri. E rëndësishme është se ushtria e Kosovës të jetë shumetnike, në të cilin janë të përfaqësuara të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Në FSK asnjë komunitet nuk është i diskriminuar, përkundrazi ka diskriminim pozitiv dhe në këtë mënyrë nuk shoh ndonjë arsye pse Kosova duhet të vonohet edhe më tutje për formimin e ushtrisë.

# po vonohet



**"Epoka e re":** *Meqenëse formimi i ushtrisë përmes ndryshimeve kushtetuese po duket i pamundur, si duhet të veprojë Qeveria e Kosovës?*
**Kastrati:** Edhe unë pajtohem se transformimi i FSK-së me anë të ndryshimeve kushtetuese, sikur po dëshirojmë të gjithë tani për tani, është i pamundur. Përfaqësuesit e komunitetit serb për arsye politike, të ndikuar nga Beogradi, nuk do t'i votojnë ndryshimet e nevojshme kushtetuese për formimin e ushtrisë. Prandaj, Qeveria e Kosovës dhe institucionet e tjera duhet t'i paralajmërojnë partnerët tanë se Kosova do ta ndjekë rrugën ligjore për ndryshimin e mandatit të FSK-së, duke ia dhënë mundësinë që FSK-ja t'i zhvillojë kapacitetet e veta ushtarake dhe të jetë e gatshme brenda një kohe të caktuar t'i kryejë obligimet që i ka në bazë të ligjeve dhe sipas nevojave që ka Kosova në aspektin e sigurisë.

**"Epoka e re":** *Mirëpo partnerët strategjikë të Kosovës dhe FSK-së kanë bërë me dije se e vetmja rrugë e pranueshme për transformimin e kësaj force është ajo përmes ndryshimeve kushtetuese. Veprimet e njëanshme në këtë drejtim sa do t'i rrezikonin raportet e FSK-së me partnerët e saj?*
**Kastrati:** Natyrisht se ata e kanë këtë qëndrim për shkak të serbëve që jetojnë në Kosovë. Mirëpo, unë mendoj se raportet e Kosovës dhe FSK-së me partnerët e saj nuk do të prishen edhe nëse shkohet në drejtim të formimit të ushtrisë me anë të ligjit. Kosova duhet t'i përmbushë nevojat e veta kombëtare në aspektin e sigurisë.

**"Epoka e re":** *Brenda çfarë kohe mendoni se Kosova duhet të veprojë në këtë drejtim?*
**Kastrati:** Institucionet tona do të duhej të caktojnë një datë se kur do të veprohet në këtë drejtim. Mendoj se këtë vit Kosova duhet të marrë vendim për t'ia ndryshuar mandatin FSK-së me anë të ligjit ashtu siç është paralajmëruar. Zgjidhje tjetër nuk ka. Ndërsa formimi i ushtrisë është shumë i nevojshëm dhe Kosova e ka këtë të drejtë, të cilën nuk mund t'ia mohojë askush. Ne jemi shtet i pavarur dhe kjo është çështje e brendshme e jona. Këtë duhet t'ua bëjmë të qartë edhe miqve ndërkombëtarë dhe nuk kemi çfarë të vonohemi më në këtë drejtim. Siç dihet, vetë dizajnimi i ushtrisë së Kosovës ka qenë në atë mënyrë që të jetë forcë mbrojtëse, e cila nuk do ta rrezikojë askënd. Po ashtu, është paraparë të jetë një forcë e cila do të kontribuojë për paqen në rajon edhe në aspektin global.

**"Epoka e re":** *Është përmendur edhe mundësia e kompromisit me përfaqësuesit serbë të Kosovës për formimin e ushtrisë. Duhet të pranohen kompromiset e përmendura në mënyrë që ta kemi ushtrinë me anë të ndryshimeve kushtetuese?*
**Kastrati:** Së pari, ushtria e Kosovës duhet të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Po ashtu, ushtria nuk mund të ketë njësite një-etnike, sepse ato janë shumë të rrezikshme. Ndërsa çështja e zëvendëskomandantit nuk është problem. Ai mund të jetë serb, boshnjak, turk, apo i ndonjë komiteti tjetër, varësisht se si pjesëtarët e komuniteteve zhvillohen në karrierë brenda FSK-së. Sa kam qenë komandant i FSK-së, tre serbë e patën përfunduar akademinë ushtarake në Maqedoni dhe ata, në bazë të zhvillimit të karrierës së tyre profesionale, mund të avancohen në karrierë dhe brenda disa vjetëve mund ta kenë gradën e duhur për t'u bërë zëvendëskomandantë. Nuk do të ishte kurrfarë pengese që zëvendëskomandanti të jetë nga komuniteti serb, por kjo nuk duhet të jetë e rezervuar gjithë kohën vetëm për serbët, sepse ne kemi edhe komunitete të tjera të cilët do të mund ta kërkojnë atë pozitë. Në të gjitha ushtritë e botës, edhe nesër në ushtrinë e Kosovës, zhvillimi i karrierës bëhet sipas ligjeve dhe standardeve që janë të përcaktuara. Nëse një serb arrin gradën e duhur për t'u bërë zëvendëskomandant, atëherë pse të mos jetë në atë pozitë. Mirëpo në atë pozitë nuk duhet të vijë dikush nga jashtë FSK-së, sepse uniformën nuk mund ta vesh dikush që vjen prej rrugës dhe bëhet zëvendëskomandant. Pra, atë pozitë duhet ta marrë dikush nga serbët që është brenda FSK-së dhe që i plotëson kushtet e kërkuara për atë pozitë.

# Haradinaj: Klina, pasuri e vlerave kombëtare dhe e tolerancës

**Klinë, 25 qershor (ER)** - "Klina është një vend i respektuar, pasuri e vlerave tona kombëtare, e trashëgimisë, tolerancës, që është për t'u çmuar dhe unë si kryetar i Qeverisë ndiej obligim që Qeveria të jetë afër jush", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj pas vizitës që bëri në Komunën e Klinës, ku është pritur nga kryetari i kësaj komune, Zenun Elezaj, me bashkëpunëtorë. "Qëllimi i ardhjes sime është që Qeveria dhe komuna të mund të jemi më të saktë në veprimet që i ndërmarrim. Shumë veprime qeverisëse janë kryekëput kompetenca të komunës, por që shumë të tjera tejkalojnë këtë kapacitet", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se saktësia e veprimit në mes të dy niveleve fiton në kohë, në kualitet, duke arritur më shpejt qytetarët përmes projekteve të parapara.
I shoqëruar nga ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, kryeministri Haradinaj ka thënë se me kryetarin Elezaj ka biseduar për temat që i shqetësojnë qytetarët e komunës siç është uji i pijshëm, ujërat e zeza, infrastruktura e cila duhet të trajtohet me kujdes. "Është edhe Miniera e Boksitit e cila, nëse aktivizohet, është resurs që hap vende të punës dhe ndikon në zhvillimin ekonomik", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.
Në këtë takim u bisedua edhe për sektorin e bujqësisë, shëndetësinë, arsimin, për dhënien në shfrytëzim të pronave të komunës të cilat do të shfrytëzohen për zhvillim ekonomik, zonë industriale dhe për fusha të tjera me rëndësi për Komunën e Klinës. Ndërkaq kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, ka pohuar se kanë marrë përkrahje për çështjet që e shqetësojnë Klinën, për furnizimin me ujë të pijes, për trajtimin e ujërave të zeza, për infrastrukturën dhe për probleme të tjera.



# Rreziqet që u shkakton fëmijëve përdorimi i tepërt i internetit

**Përdorimi i internetit dhe teknologjisë sot është një nga trendët e përhapur në gjithë botën. Por, sikurse në shumë vende të tjera, edhe në Kosovë shqetësues mbetet përdorimi i tepërt dhe i pakontrolluar i internetit nga fëmijët**




PRISHTINË, 25 QERSHOR - Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, kurse 97 për qind e fëmijëve kanë qasje në internet. Kështu thuhet në hulumtimet e bëra nga organizatat që merren me studime kibernetike. Gjithashtu, fëmijët gjatë përdorimit të internetit kanë takime me njerëz të panjohur, shohin skena dhune apo pornografi, kanë ngacmime të ndryshme, që ndikojnë negativisht në shëndetin e tyre mendor, thonë psikologët në vend.

Teuta Zymeri, drejtoreshë ekzekutive e Qendrës për Studime të Avancuara, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se shpesh kanë kërkesa nga prindërit që t'u ndihmojnë fëmijëve të tyre për gjendjen emocionale, që ka çuar deri në tentim-vetëvrasje, për shkak të ngacmimeve në internet. "Interneti i ka të mirat dhe të metat e veta. Nëse përdoret në mënyrë të pakontrolluar, sidomos tek fëmijët, ka efekte shumë negative. Kemi pasur kërkesa për ndihmë nga prindërit, por edhe nga fëmijët, kur fëmijët janë të rrezikuar dhe kanë problem. Kemi pasur raste kur fëmija ka qenë para aktit të vetëvrasjes për shkak të postimeve të fotografive në publik nga shokët e tyre, më pas tallja nga fëmijët e tjerë. Kemi qëlluar në kohën dhe momentin e duhur dhe me ndihmën e psikologëve është evituar më e keqja. Rastet e tilla nuk janë të rralla. Gjatë hulumtimeve tona të vazhdueshme kemi hasur në atë se fëmijët kanë takime me njerëz të panjohur, pornografia që shohin fëmijët, lojërat online dhe varësia nga to, si dhe rrjetet sociale, që janë shumë të përdorura", ka deklaruar Zymeri.

Ndërsa psikologu Besnik Peci ka bërë me dije se ngacmimet përmes internetit janë çështje e diskutueshme në nivel global. Por, më së shpeshti viktima janë fëmijët, ku sidomos lojërat e ndryshme kibernetike kanë ndikuar emocionalisht apo edhe kanë çuar deri në vetëvrasje, pasi ata nuk kanë identitet emocional. "Dhuna përmes internetit në raste të caktuara është më e rëndë sesa dhuna emocionale dhe psikologjike që e marrin fëmijët. Si rezultat i kësaj, fëmijët në të ardhmen kanë pasoja psikologjike dhe emocionale si dhe integrimi i tyre në shoqëri është shumë i vështirë si rezultat i talljeve publike që bëjnë fëmijët në kurriz të tjetrit", ka theksuar Peci.

Ai ka shtuar se duhet bërë më shumë në aspektin e përfshirjes së kësaj pike në planprogramet shkollore në Kosovë. "Mendoj se në planprogramet shkollore duhet marrë hapa konkretë dhe të zbatohen ato sa i përket përdorimit të drejtë të internetit. Mendoj se është bërë më se e domosdoshme prania e psikologëve në shkolla dhe bashkëpunimi i trekëndëshit fëmijë, prind, mësimdhënës në mënyrë që të mbrohen fëmijët nga kjo dukuri", është shprehur Peci.

Por, Zymeri ka theksuar se bëjnë vazhdimisht fushata vetëdijësuese në shkolla e terren, ku tashmë po përdoret edhe trekëndëshi fëmijë-prind-arsimtar për t'i ndihmuar fëmijët në rast nevoje, pikërisht nga përdorimi i gabuar i internetit. Sipas hulumtimeve të Qendrës për Studime të Avancuara, 43 për qind e fëmijëve në Kosovë që kanë kontaktuar me persona të panjohur përmes internetit, 32 për qind e fëmijëve janë shqetësuar pas takimeve që i kanë pasur.

# UP-ja mban punëtori për planin strategjik, të arriturat dhe sfidat



EPOKA E RE **Arbisa SHEFKIU**

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" ka organizuar një punëtori dyditore me qëllim të vlerësimit të progresit të zbatimit të Planit Strategjik 2017-2019 (PSUP), ku kanë marrë pjesë menaxhmenti qendror dhe dekanët e njësive akademike. Kjo punëtori u fokusua në progresin dhe sfidat drejt implementimit të këtij plani deri në gjysmën e kohëzgjatjes së tij që nga aprovimi i këtij dokumenti, si dhe në sfidat që e presin UP-në në gjysmën e dytë të zbatimit të PSUP-së.

Në përfundim të kësaj punëtorie u themelua një grup punues, i cili paraqiti konkluzionet nga ky takim dhe rekomandimet për veprim në pjesën e dytë të zbatimit të PSUP 2017-19. Gjatë punëtorisë në fjalë u paraqiten nismat e shumta në drejtim të ngritjes së cilësisë, ngritjes së mbështetjes në fushën e kërkimit dhe hulumtimit, lidhjen e programeve me tregun e punës e të tjera nisma. Po ashtu, u vu në pah fakti se UP-ja tashmë ka krijuar standarde dhe rregullore, duke themeluar kështu bazën për ngritjen tutje të këtij institucioni amë të arsimit të lartë në vend.

Gjithashtu, gjatë kësaj punëtorie u paraqitën sfida të shumta, sidomos ato që lidhen me decentralizimin e njësive akademike, digjitalizimin e sistemeve financiare dhe prokurimin, avancimin e sistemeve të raportimit online dhe në kohë të mbajtjes së ligjëratave dhe pjesëmarrjes së studentëve, lansimin e E-Bibliotekës në mënyrë që t'u ofrohet studentëve qasje më e lehtë në zhvillimet e fundit.

Ndërkaq sfida kryesore ishte të punohet më tepër në gjetjen e modalitetit të qëndrueshmërisë financiare të universitetit.

Punëtoria u vlerësua lart nga të gjithë të pranishmit dhe u vendos të mbahen takime të këtij niveli çdo tre muaj, por tani e tutje të fokusuara sipas shtyllave strategjike të PSUP-së, siç janë: ngritja e cilësisë, mësimdhënia dhe të nxënit, hulumtimi dhe projektet, ndërkombëtarizimi e të tjera.

# Haradinaj: Ta kthejmë besimin në institucione

Kryeministri Ramush Haradinaj, në takimin e lartë për sundimin e ligjit, ku u prezantua puna e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, e Agjencisë Qendrore të Prokurimit dhe e Organit Shqyrtues të Prokurimit, ka kërkuar nga drejtuesit e këtyre mekanizmave - që rregullojnë funksionimin e prokurimit publik - të angazhohen më shumë për arritjen e rezultateve dhe rritjen e besimit të qytetarëve



EPOKA E RE Faton DERMAKU

PRISHTINË, 25 QERSHOR - "Të gjithë duhet të jemi të përgjegjshëm për detyrat që i kemi dhe nga pozicioni ku jemi duhet ta japim maksimumin që ta kthejmë besimin në institucionet e vendit dhe ta përmirësojmë punën tonë", ky ishte mesazhi i kryeministrit Ramush Haradinaj në takimin e së hënës, i teti me radhë, i nivelit të lartë për sundimin e ligjit, ku u prezantuan të arriturat e muajve të fundit nga institucionet përkatëse, në veçanti puna e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, Agjencisë Qendrore të Prokurimit dhe Organit Shqyrtues të Prokurimit.
Kryeministri Haradinaj ka kërkuar nga drejtuesit e këtyre mekanizmave që rregullojnë funksionimin e prokurimit publik që të angazhohen më shumë për arritjen e rezultateve dhe rritjen e besimit të qytetarëve, duke theksuar se prokurimi publik është pjesë e rëndësishme e reformave që kërkohet t'i bëjë Qeveria e Kosovës në rrugën drejt integrimit në BE. Ai ka thënë se Kosova ka shënuar progres sa i përket prokurimit, duke theksuar se Strategjia Kombëtare e Prokurimit Publik për periudhën 2017-2021,është një prej strategjive shumë të rëndësishme për vendin.
Safet Hoxha, kryetar i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, ka prezantuar në detaje punën e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, duke theksuar se 97 % e të gjitha procedurave dhe aktiviteteve të prokurimit kryhen përmes platformës elektronike të prokurimit. "Platforma e prokurimit elektronik është një nga sistemet më të përdorura në nivel qeveritar dhe biznesi", është shprehur Hoxha. Kurse kryetari i Bordit të KRPP-së ka folur edhe për sfidat që e kanë përcjellë KRPP-në gjatë vitit 2017 në zbatimin dhe funksionalizimin e prokurimit elektronik për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme të KRPP-së dhe mosadaptimit të legjislacionit aktual me prokurimin elektronik. Ndërsa në prezantimin e Agjencisë Qendrore të Prokurimit u tha se janë 16 institucione për të cilat kjo agjenci i kryen procedurat e Prokurimit, kurse sfidë mbetet mungesa e resurseve dhe vonesa në bashkëpunim e autoriteteve kontraktuese.
Nga ana tjetër, Blerim Dina nga OShP-ja ka pohuar se në vitin 2017 janë pranuar 541 ankesa në këtë institucion dhe janë shqyrtuar 459 apele, kurse sfidë e këtij organi mbetet mungesa e personelit mbështetës dhe mosekzekutimi i vendimeve.
Në këtë takim, i cili u kryesua nga kryeministri Haradinaj, u prezantuan edhe të arriturat në Ministrinë e Drejtësisë, Doganën e Kosovës, Policinë e Kosovës, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Gjykatën Supreme dhe Agjencinë Kundër Korrupsion. Nga këto prezantime u kuptua progresi i arritur në këto institucione në muajt e fundit, veçmas në rekrutimin e gjyqtarëve të rinj dhe stafit mbështetës dhe në kalimin e projektligjeve nga ana e Qeverisë së vendit, tejet të nevojshme për përafrimin me agjendën evropiane. Pjesë e takimit ishin edhe ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Greg Delawie, shefja e Misionit të BE-së, Nataliya Apostolova, shefja e EULEX-it, Alexandra Papadopoulos, shefja e Misionit të USAID-it, Lisa Magno dhe përfaqësues të tjerë institucionalë.




# Kërkohet angazhim maksimal për realizimin e projekteve të BE-së

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Të hënën është mbajtur takimi iniciues i procesimit të programeve kombëtare për Kosovën, IPA 2019 dhe IPA 2020, të financuara nga Bashkimi Evropian, ku kanë marrë pjesë ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, drejtues të Zyrës së BE-së, diplomatë dhe drejtues institucionesh ekzekutive të Qeverisë së Kosovës. Në hapjen zyrtare u prezantua qasja e përbashkët që do të ndiqet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Ministrisë së Integrimit Evropian si koordinuese nga ana e Kosovës për afatet kohore të procesit të programimit, sektorët që do të përkrahen nga këto programe.
Ministrja Hoxha, në cilësinë e Koordinatores Kombëtare për IPA, ka theksuar se qëllimi i institucioneve të Kosovës është që duke filluar prej tani e deri në mesin e vitit të ardhshëm, ta kryejnë të gjithë procesin e programimit të IPA 2019 dhe IPA 2020. "Ashtu që më pas, të kemi kohë të përqendrohemi në fazën e planifikimit për instrumentin e ri që do të zhvillohet për periudhën e re financiare të BE-së, 2021-2027", ka thënë Hoxha.??
Ministrja ka theksuar se pret nga përfaqësuesit e Zyrës së BE-së të njoftojnë rreth kufijve financiarë të programeve 2019 dhe 2020, për afatet e nevojshme për t'i dorëzuar kërkesat te BE-ja për financim, rreth sektorëve të cilët do të financohen, si dhe rreth modaliteteve të zbatimit të projekteve në këta sektorë. "Ministria ka pranuar një numër propozimesh nga ana e institucioneve tona dhe ne e kemi njoftuar paraprakisht Zyrën e BE-së për këto kërkesa. Duke filluar nga sot, së bashku do të nisim një dialog ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe BE-së rreth ideve më të mira për mbështetje, duke u bazuar në kufijtë financiarë të cilët janë vendosur nga BE-ja. Prandaj, ftoj përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës që sot t'i prezantojnë propozimet për projektet e tyre dhe të paraqesin se cilat janë prioritetet më të rëndësishme të tyre", ka thënë ministrja Hoxha.
Pas fjalës hyrëse të ministres Hoxha u paraqiten propozimet dhe projektet që priten të financohen nga BE-ja, me IPA 2019, IPA 2020.




# Beqaj: Kosova është duke zbatuar programin e ekonomisë digjitale

SOFJE, 25 QERSHOR (ER) - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka thënë se ekonomia globale digjitale ofron mundësi për integrim e Kosovës në tregun global të punës. "Qeveria e Kosovës teknologjinë e informacionit dhe komunikimit e konsideron një nga sektorët më të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe transformim strukturor drejt një ekonomie dhe shoqërie të bazuar në dije", ka thënë Beqaj në "Digital Assembly 2018" që po mbahet në Sofje të Bullgarisë, organizuar nga Komisioni Evropian dhe Presidenca Bullgare e Këshillit të BE-së.

Ministri Beqaj si pjesë e panelit "Lansimi i agjendës digjitale për Ballkanin Perëndimor", së bashku me komisionaren Mariya Gabriel dhe ministrat e rajonit, ka shpalosur të arriturat dhe planet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e agjendës digjitale si pjesë e procesit të WB6. Ministri Beqaj ka theksuar se potenciali i Kosovës për integrim në tregun global është i madh pasi vendi ka popullatë të re dhe të shkathtë në fushën e TIK-ut dhe ofrimin e shërbimit në këtë sektor të rëndësishëm ekonomik.

Beqaj ka folur edhe për mundësitë e zhvillimit të Kosovës në sektorin e teknologjisë informative, duke theksuar se Kosova njihet si vend me penetrim të gjerë të internetit në shkallë vendi që arrin afërsisht në 88 për qind. Ministri Besim Beqaj ka siguruar se Qeveria e Kosovës është duke zbatuar programin e ekonomisë digjitale të Kosovës - KODE, në bashkëpunim me Bankën Botërore.

# Nënshkruhet memorandumi për rritje të përkrahjes sociale

PRISHTINË, 25 QERSHOR (ER) - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe organizata gjermane "Arbeiter-Samariter-Bund (ASB)" kanë nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit në kuadër të implementimit të projektit, "Iniciativa për dimension social të integrimit evropian" për Ballkanin Perëndimor.

Marrëveshja u nënshkrua nga ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica dhe drejtori i ASB-së për Evropën Juglindore, Emir Bojadziç.

Qëllimi i këtij memorandumi është avancimi i sistemit të mbrojtjes sociale dhe ngritja e kapaciteteve të qeverive lokale, si dhe përkrahja e grupeve të ndryshme sociale, nëpërmjet implementimit të projektit "Iniciativat për dimension social".

Bojadziç ka falënderuar ministrin Reçica për gatishmërinë për bashkëpunim të vazhdueshëm ku tashmë ASB dhe MPMS veçse kanë nënshkruar një marrëveshje gjatë muajit mars të këtij viti për stabilitet socio-ekonomik të komuniteteve etnike pakicë dhe shumicë.

Ndërkaq ministri Reçica ka shprehur gatishmërinë e plotë të tij dhe të MPMS-së për të bashkëpunuar me organizatën ASB, me qëllim të përmirësimit të mirëqenies sociale të qytetarëve të Kosovës dhe në kuadër të kësaj ka falënderuar Bojadziç për përkrahjen që organizata po i jep Kosovës në këtë pikë.

Reçica ka theksuar se MPMS-ja do t'i përmbushë të gjitha obligimet e nevojshme në bazë të memorandumit të nënshkruar që kanë të bëjnë me selektimin e disa komunave që ballafaqohen me probleme më të mëdha në fushën sociale ku do të implementohen projektet e ASB-së.



# Abdixhiku propozon që institucionet mikrofinanciare t'ia kthejnë fitimin shtetit



Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, ka propozuar që 30 milionë euro të cilat i kanë fituar institucionet mikrofinanciare në kuadër të operimit të tyre si OJQ, të investohen në një projekte kapitale në të mirë të qytetarëve

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Komisioni për Buxhet dhe Financa, i udhëhequr nga Lumir Abdixhiku, kryetar, ka mbajtur të hënën dëgjim publik për Projektligjin për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare. Abdixhiku ka theksuar se një zgjidhje ideale për çështjen e institucioneve mikrofinanciare në Kosovë do të ishte që kapitali i mbledhur t'i mbetet shtetit, fitimi i akumuluar të tatimohet në mënyrë retroaktive dhe këto institucione të bëhen të qëndrueshme dhe në mbikëqyrjen e BQK-së, me tendencën e uljes së normave të interesit. Ai ka thënë se 30 milionë euro që kanë fituar institucionet mikrofinanciare në kuadër të operimit të tyre si OJQ, do të ishte mirë të investohen në projekte kapitale në të mirë të qytetarëve.

Arsim Bruçaj nga Asociacioni i Institucioneve Mikorfinanciare të Kosovës ka shprehur gatishmërinë që kanë institucionet mikrofinanciare për ta dhënë kontributin për të gjetur një zgjidhje ligjore për funksionimin e këtyre institucioneve. Ai ka propozuar që OJQ-të të mos shiten. Sipas Bruçajt, ato nuk do të shuhen në mënyrë që kapitali i tyre të përdoret për statusin për të cilin veprojnë.

Taulant Hoxha nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile ka shtruar kërkesat e këtij fondacioni, të cilat ishin: ruajta e parimit të themelimit të OJQ-ve dhe mosndërhyrja në autonominë e OJQ-ve, respektimi i aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese dhe të mos bëhet ndërlidhja e këtij projektligji me Projektligjin për Lirinë e Asociimit në organizatat joqeveritare.

Anëtarët e komisionit dhe deputetët e pranishëm theksuan nevojën e gjetjes së zgjidhjeve ligjore për këto institucione mikrofinanciare, duke pasur parasysh kornizën ligjore dhe për efektet ekonomike në sistemin financiar, që ndikon puna e këtyre institucioneve.

Nait Hasani nga PDK-ja ka thënë se fondi prej 30 milionë eurosh duhet të jetë fond që i shërben shtetit. "Kjo çështje është shumë e paqartë ngaqë projektligji nuk i ka lejuar formën e tillë të organizimit të mikrofinancave", është shprehur Hasani.

Kurse deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka thënë se këto institucione kanë devijuar nga misioni për të cilin janë themeluar. Ajo ka deklaruar se zgjidhja e vetme është që kontribuuesit në këtë kapital të jenë përfitues të kapitalit. "Me vetë faktin që janë krijuar këto institucione për t'u marrë me grupet e marxhinalizuara dhe, në anën tjetër, i kanë ngarkuar deri 28 % me norma të interesit qytetarët, atëherë këto kanë devijuar nga misioni i tyre. Unë konsideroj se e vetmja zgjidhje do të ishte që kontribuuesit në këtë kapital të jenë përfitues të kapitalit. Nuk mund të lejojmë diçka tjetër, sepse është komplet e papranueshme", ka deklaruar Bajrami.

Kritika të shumta ndaj këtyre institucioneve ka dhënë edhe deputeti i Nismës Socialdemokrate, Milaim Zeka, i cili ka akuzuar edhe ambasadat ndërkombëtare për moslejimin e ndryshimit të ligjit. Zeka ka thënë se këto institucione kanë krijuar piramida në Kosovë, ku si rast konkret ka marrë Shqipërinë në vitin 1997. "Unë jam për prishjen e këtyre piramidave. Është krijuar piramida e së keqes dhe këtë duhet ta ndalojmë", ka thënë Zeka, i cili për këtë çështje ka hedhur akuza tek përfaqësuarit e BQK-së dhe bankave të tjera që kanë lejuar të japin kredi me norma të larta të interesit. "Amendamenti i hequr ka mundësi që këto institucione mos ta deklarojnë fitimin në Administratën Tatimore të Kosovës, pasi ka pasur edhe ndërhyrje të ambasadave të huaja", ka thënë ai.

Kurse deputeti i Partisë Socialdemokrate, Dardan Sejdiu, ka thënë se është e rëndësishme të mos bllokohet Ligji për OJQ-të.

## Pagat e Trustit nivelohen me ato të BQK-së

PRISHTINË, 25 QERSHOR (ER) - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka bërë me dije se pagat e menaxhmentit të Fondit Pensional (Trusti) përfundimisht nivelohen me ato të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK). "Siç ju kam paralajmëruar më parë, pas iniciativës të komisionit që udhëheq, pagat e menaxhmentit të TRUST-it përfundimisht, pas 10 vjetëve debat, nivelohen me ato të BQK-së. Sot pranova njoftimin e Bordit të Trustit që konfirmon këtë ndryshim dhe zvogëlim. Jam i lumtur për këtë. Kemi konsideruar vazhdimisht se pagat prej 6 000 eurosh ishin joproporcionale me rendin institucional në vend dhe me nivelin ekonomik në Kosovë", ka shkruar Abdixhiku në profilin e vet në "Facebook". Sipas tij, do të ishte mirë që shembulli i tillë të ndiqej edhe nga Qeveria dhe institucionet e tjera në vend që, fatkeqësisht, sipas tij, tani për tani kanë zgjedhur rrugë krejt tjetër.



## Kryetari Latifi mban debatin e parë publik me qytetarë



Rahovec, 25 qershor (ER) - Bazuar në Ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe statutin e Komunës së Rahovecit, kryetari i komunës, Smajl Latifi, ka mbajtur të hënën debatin e parë publik me qytetarë. Gjatë debatit kryetari Latifi i ka informuar qytetarët që ishin të pranishëm në debat për punën gjashtëmujore dhe zhvillimet aktuale në komunë dhe planifikimet për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2018. Latifi i ka informuar qytetarët rreth buxhetit dhe realizimit të tij deri më 22 qershor 2018, realizimi i të hyrave komunale, obligimet financiare për këtë vit dhe obligimet e kontraktuara.

# Kujtohet dita kur Richard Holbrooke vizitoi kullat e Junikut



Junik, 25 qershor - Është mbajtur manifestim jubilar për nder të 20-vjetorit të vizitës të emisarit special të shteteve të bashkuara të Amerikës, Richard Holbrooke, bërë kullave të Junikut, të cilat në atë kohë ishin duke u qëndruar heroikisht sulmeve së bashku me djemtë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), me një disiplinë dhe rregull ushtarak të nivelit të lartë që kishte organizuar komanda e Junikut.
Nga kullat e Junikut, Richard Charles Albert Holbrooke e ka përcjellë mesazhin te ndërkombëtarët se UÇK-ja është një ushtri e cila ka organizim të mirëfilltë dhe se po mbron tokën e vet, po lufton për lirinë e vet dhe nuk është ushtri çfarë armiku e kishte paraqitur te të tjerët.
Kryetari i Komunës së Junikut, Agron Kuçi, e ka kujtuar këtë datë të veçantë si një ndër datat më historike për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në atë kohe. Ai ka thënë se njohja e UÇK-së ka bashkuar shumë miq ndërkombëtarë të cilët dolën në krahë të çlirimtarëve dhe larguan pushtuesin nga këtu.
Në këtë takim morën pjesë ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, gjenerali i FSK-së Nazmi Ibrahimi, ish-zëdhënësi i UÇK-së, Lumë Haxhiu, deputetja Teuta Haxhiu, përfaqësues të organizatave të luftës, shoqërisë civile dhe qytetarë nga Juniku dhe më gjerë.

## KEDS-i investoi tri trafo dhe disa kilometra rrjet të ri në Sofali të Prishtinës

Prishtinë, 25 qershor (ER) - Lagjja "Sofalia" afër Gërmisë në Prishtinë ka marrë një pamje të re pas përfundimit të projektit energjetik të KEDS-it. Janë 148 familje që përfitojnë nga ky investim.



Deri para përfundimit të projektit nga KEDS-i, banorët e lagjes janë furnizuar vetëm nga një trafo, që ka qenë e pamjaftueshme për t'i përmbushur nevojat energjetike për popullatën e këtushme.
Sofalia çdo ditë po zgjerohet me shtëpi dhe ndërtime të reja. Me shtimin e popullatës është paraqitur nevoja për rritjen e kapaciteteve të reja energjetike.
Për këtë projekt KEDS-i ka vendosur tri trafo. Një trafo e tipit blind me fuqi prej 630 kVA, një tjetër e tipit shtyllë me fuqi 160 kVA dhe një trafo po e tipit shtyllë me fuqi 100 kVA.
Gjithashtu, është shtrirë një rrjet ajror prej 4,5 km të tensionit të ulët dhe 1 km rrjet ajror të tensionit të mesëm dhe 980 m rrjet nëntokësor. Kurse shtyllat janë vetëm prej betoni, 95 shtylla të tensionit të ulët dhe 14 shtylla të tensionit të mesëm.
Banorët e lagjes falënderojnë KEDS-in për këtë infrastrukturë të re energjetike. "Me këto investime dhe ndryshime që ka bërë KEDS-i në rrjetin energjetik, tash e kemi shumë më mirë. Pajisjet elektrike i kemi të sigurta dhe nuk e kemi më atë frikën nga telat e zhveshur. Tani edhe tensioni është stabilizuar. Falënderojmë KEDS-in për punën që ka bërë", ka thënë Fikrije Bojniku, banore e lagjes.
Investimet e këtilla, gjithnjë sipas planit të paraparë, do të shtrihen në të gjithë territorin e Kosovës.

## Xhirimet kryesore të filmit 'Shpata prej druri' do të bëhen në Mitrovicë

Mitrovicë, 25 qershor (ER) - Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci dhe Nehat Bahtiri, shef i kabinetit të kryetarit, kanë pritur në takim aktorin e njohur Fatmir Spahiu.
Aktori Spahiu i ka njoftuar zyrtarët e lartë komunalë lidhur me projektin filmik "Shpata prej druri", një bashkëpunim ky në mes të Kosovës dhe Turqisë, xhirimet kryesore të të cilit do të bëhen në qytetin e Mitrovicës.
Nënkryetari Mujka, i cili ishte shumë i kënaqur me vizitën e aktorit Spahiu, ka ofruar mbështetjen e plotë të institucioneve komunale për realizimin e projektit. Komuna në këtë rast ofron mbështetjen brenda mundësive që ka, duke siguruar edhe lokacionet ku do të bëhen xhirimet e këtij filmi.
Ndërsa drejtori i DKRS-së, Tafil Peci, ka uruar aktorin Spahiu, duke shpresuar në realizimin e suksesshëm të këtij filmi. Ai ka



theksuar se xhirimi i filmit në qytetin e Mitrovicës do të kontribuojë për ngritjen e epitetit të qytetit si një qytetet me vlera të larta kulturore dhe artistike.
Filmi "Shpata prej druri", me skenar të Selman Kiliçaslan dhe me regji të Emre Konuk, trajton temën e një djali nga Krusha e Madhe i cili i ka prindërit e zhdukur që nga lufta e Kosovës dhe kërkon hakmarrje ndaj forcave serbe.
Në këtë film rolet kryesore do t'i luajnë aktorët: Florist Bajgora, Vedat Bajrami, Mensur Safciu, Luan Jaha, Çun Lajçi, Astrit Kabashi, Ilir Prapashtica, Irena Canhasi, Xhejlane Terbunja dhe të tjerë.

## Malisheva është e gatshme për fushatën e korrje-shirjeve



Malishevë, 25 qershor (ER) - Nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, ka udhëhequr mbledhjen e rregullt javore me drejtorët e drejtorive komunale, ku nga raportet e drejtorëve u njoftua për zhvillimet e javës që kaloi dhe me punët e kryera në terren.
Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Murat Hoxha, ka raportuar për përgatitjet që janë bërë në Komunën e Malishevës për fushatën e korrje-shirjeve. Ai ka bërë me dije se janë të mbjellë rreth 3 700 hektarë me grurë dhe elb në këtë komunë. Hoxha ka theksuar se sipas ekspertëve, rendimentet për hektar me grurë priten të sillen deri në 4 000 kilogramë.

Një rrugë për Enverin (2)

# ‘KONSUJT’ E ENVERIT NË KOSOVË



Nga Bedri ISLAMI

Njëra ndër figurat më madhore dhe nacionalist i shkallës më të lartë, Jusuf Gërvalla, në pyetjen e gazetës gjermane "Die Zeit", nëse do të pranonin të bashkoheshin me Shqipërinë, edhe nëse ai vend do të ishte monarki, shtet kapitalist apo një vend komunist, ai do të përgjigjej thjesht: "pa asnjë ngurrim".

Zgjedhja e tyre nuk ishte në dorën e tyre. Po të kishte qenë monarkia në pushtet, ata do të ishin mbështetur tek figura e monarkut; po të ishte Shqipëria një vend kapitalist ata përsëri do të mbështeteshin, si ndodhi në vitin 1998.

Për shqiptarët e Shqipërisë londineze nuk është edhe aq e kuptueshme se çfarë ndjenje të zgjon fakti kur i mënjanuar, i burgosur me dhjetë vite a më shumë, pa e ditur nëse ka mbështetje apo jo; pra një vetmitar kur e di se qëllimi është i shenjtë, por nuk e di nëse ke zgjedhur rrugën e drejtë, vjen në qeli, në atë bashkësi burgu, mesazhi i shumëpritur është se shteti amë të mbështet.

Në burg nuk ke as kohën dhe as luksin të mendosh për një gjë tjetër , veç këtij: ke mbështetje, ke një prag ku të dëgjojnë.

***

Shteti shqiptar bëri kujdes që, në afrimin e tij me lëvizjen çlirimtare, të hiqte ideologjinë dhe të mos bënte primare figurën e Enverit. Kjo është bërë me urdhrin e tij. Në një letër që i dërgon Jusuf Gërvallës dhe lëvizjes çlirimtare, në vitin 1981, ai i këshillonte të hiqnin dorë nga ideologjia, sidomos ajo ML, të mos e lidhnin përpjekjen e tyre me emrin e vetë Hoxhës, dhe, në të njëjtën kohë bënte dallimin mes Ballit Kombëtar në Kosovë dhe Ballit Kombëtar në Shqipëri, duke e cilësuar të parin si një lëvizje nacionaliste të domosdoshme dhe atdhetare. Po ashtu, në shënimet e saj, ish ministrja e arsimit dhe e kulturës në Shqipëri, Zonja Tefta Cami, do të sillte porosinë e Hoxhës, në prag të vizitës së saj të parë në Kosovë, viti 1980, se nuk duhet folur për asgjë ideologjike me kolegët e saj në Kosovë, nuk duhej të citohej ai dhe as Partia e Punës.

Nga ana tjetër, po kjo lëvizje çlirimtare, sipas dëshmisë së drejtuesve të kohës, do të ndihmohej me miliona dollarë nga shteti amë. Dhe, nga ana tjetër, do të përçahej, po nga shteti amë, në bashkimin e tyre. Atë që jepte dora e majtë, e merrte dora tjetër. Fakt është se ata që lëviznin dorën tjetër, në një kohë të ardhshme, do të shfaqeshin si njerëzit që e kishin keqtrajtuar çështjen e Kosovës. Shembulli më tipik do të ishte ish ambasadori i Shqipërisë në Turqi, Bujar Hoxha, i cili pasi ndaloi bashkimin e saktë të grupeve të rezistencës në një linjë të vetme, pak muaj më vonë, pas vrasjes së Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës, krijoi një bashkim tjetër, ku nga tre përfaqësues, dy kishin qenë njerëz të lidhur fort me shërbimin sekret jugosllav.

***

Vitet e shkrirjes së akujve të parë, në kohën kur nga njëra anë qeveriste Hoxha dhe nga ana tjetër Tito, do të jenë përballjet e para serioze mes dy qëndrimeve që do të vinin në provë shqiptarët. Kë do të përqafonin ato: një jetë më të qetë, megjithëse nën kornizën e autonomisë apo bashkimin me shtetin shqiptar, ashtu si ishte ai.

Fakti është se mes dy përballjeve, delegimit të mendjes dhe artit, kulturës dhe shkencës shqiptare në Kosovë dhe jetës së shqiptarëve të atjeshëm, fitoi e para. Mendja e mundi fuqinë e pushtetit. Kadare, Çabej, Demiraj, Buda, Pollo (i vjetri), Kostallari, Agolli etj, në mënyrë simbolike, e mundën Kol Shirokën, Sinan Hasanin, Fadil Hoxhën, Veli Devën, Xhavit Nimanin.

Enver Hoxha nuk kishte mundur ta bënte këtë. Edhe sikur të kishte dashur, nuk do të kishte mundur ta bënte. Por, këta, të mendjes, në Kosovë, konsideroheshin konsujt e tij, dhe përmes tyre ai mund të bënte një vend tjetër.

Shpesh herë Hoxha akuzohet rëndë se, në kohën e tij, shumë shqiptarë të Kosovës, të cilët erdhën në dheun amë, u burgosën, u dërguan në kampe internimi, kaluan nëpër zgafellat e galerive të Spaçit apo në errësirën e Burrelit etj.

Ka qenë vërtet një krim i shumëfishtë, i një mendjeje të sëmurë, që nuk duhej të ndodhte dhe kurrë nuk mund të shlyhet.

Por, ka dy shfaqje të këtij por-i. Disa prej tyre ishin të dërguar të shërbimit sekret serb. Ishin nga ata që, pasi ishin instruktuar, kishin ardhur për të bërë detyrën ndaj një shteti tjetër. Rastet e njohura si të "Pashtrikut", të "Kontit", të "Hutinit", të "Safetit", nuk kanë qenë të veçuara, por nuk justifikojnë edhe atë që ka ndodhur.

Shumë nga këta ish të burgosur politikë, shqiptarë të Kosovës, pas ndryshimeve pluraliste, u përfshinë në jetën politike, nganjëherë më ashpërsisht se sa ishte menduar. U bënë edhe deputetë, edhe funksionarë të lartë të pushtetit të ri, këshilltarë, drejtorë drejtorie të rëndësishme, në Shërbimin Informativ, në ambasada.

Disa e meritonin, disa e përdorën kalvarin për të risjellë në vëmendje se, e shkuara e tyre, pavarësisht se si e kishin shfaqur, nuk kishte ndryshuar asgjë në mentalitetin e tyre.

Ata, megjithëse u paraqitën si atdhetarë të shquar, e kishin rastin kur do e dëshmonin veten: luftën e Kosovës.

Ndoshta jo të gjithë, por shumë prej tyre, në një mënyrë ose në një tjetër, u përfshinë në struktura që ishin kundër luftës, kundër qëndresës, u përpoqën ashpërsisht për ta mposhtur këtë luftë, gjë që ishte e kundërta e asaj me të cilën ishin paraqitur në Shqipëri, si pjesë e lëvizjes çlirimtare në Kosovë.

***

Figura e Enverit në Kosovë, aq sa ka qenë e afrueshme, aq ka qenë edhe shenjë largësie. Por, si nuk është pritur, sidomos nuk është pritur gjatë viteve 1990-1998, dufi dhe mllefi më i madh kundër tij, do të ishte pikërisht në Kosovë.

Nuk ndodhi rastësisht një gjë e tillë. Viti 1990 erdhi pas përplasjeve të jashtëzakonshme të vitit 1989, që mund të quhet viti fillestar i luftës së armatosur. Në nëntorin e këtij viti, 1989, e gjithë Kosova u trondit nga lëvizjet e mëdha të organizuara nga strukturat ilegale. Duam apo nuk duam sot, frymëzimi i tyre erdhi nga Shqipëria dhe pavarësisht se Hoxha nuk jetonte më dhe se zëvendësuesi i tij nuk kishte as karizmin e tij dhe as fjalët e tij, ata përsëri besonin. Takimet e fshehta që ishin bërë në selinë presidenciale u kishin dhënë shpresë për mbështetje të fuqishme. Ishte, ndoshta, viti më domethënës i ndryshimit.

Për të mos pasur një vit tjetër të tillë, duhej zhbërë urgjentisht mbështetja. Për të hequr mbështetjen duhej shuar figura e Hoxhës. Duhej krijuar miti i shitjes së Kosovës, i braktisjes së saj, i tmerrit që kishin kaluar vetë shqiptarët, i tmerrit që nuk kishte fund, i harresës së madhe, që të hiqej ajo që kishte qenë, herë e fortë e herë më e larguar, mbështetja.

Fakti që në instancat themelore të Kosovës, në politikë, në media, në jetën publike, në administratë ishin ish anëtarët e Lidhjes Komuniste të Kosovës, e shfaqur tashmë si LDK; fakti që kjo Lidhje ishte krijuar nga një grupim i lidhur me strukturat e sigurisë serbe, fakti që programi i tyre i paraqitur nga Jusuf Buxhovi ishte punuar në zyra të tjera, ende i papërkthyer mirë, që duhej domosdo të spostohej vëmendja nga reali, ai që ishte i pranishëm me ushtri, banka, polici, gjykatë drejt një vendi tjetër, e bëri këtë përpjekje të ethshme, të pashoqe dhe të egër.

Edhe sot, mund të duket e çuditshme, në Kosovë, shumë vetë e dinë fare mirë se kush ka qenë Kadri Hazbiu, Mehmet Shehu, sa janë vrarë e si janë vrarë dhe, theksoj, mirë bëjnë që e dinë dhe duhet ta dinë, por, të njëjtët nuk e dinë se kush ishte Rankoviqi, kush ishin ministrat e brendshëm në Kosovë, kush ishte Mehmet Maliqi, Jusuf Karakushi, Sinan Hasani, megjithëse disa nga këta të fundit ende i kanë emrat e tyre nëpër rrugët e rruginat e Kosovës.

Heqja e mitit të Hoxhës ka qenë domosdoshmëri për regjimin serb. Ka qenë njëra ndër frikërat e tij. E, më duhet ta them se, shumë nga ata që e filluan luftën në Kosovë, dikur, i kishin besuar Hoxhës dhe e kishin gjetur veten tek rruga e tij, luftë për çlirim.

Ata mund të fajësohen për gjithçka; ata mund të quhen edhe nostalgjikët e fundit të një regjimi që pak kush e donte dhe ndaj një figure të cilin sot e kanë mënjanuar, por në kohën e tyre ata nuk gjetën rrugë tjetër.

Ata kishin gjithë botën kundër dhe u mbështetën tek një njeri, emri i të cilit, edhe nëse synohet të jetë në fillimin e mbarimin e një rruge, ndjell kundërshtitë më të mëdha, përplasje të panjohura, zgjon kohë të tjera dhe nuk gjen vend askund.

E gjitha kjo ndodh pasi, megjithëse kanë shkuar kaq shumë vite, ende nuk kemi një histori reale, të një rruge, e cila, në ecjet e saj, kishte enigma të shumta, krime dhe ndërtim shteti, kishte mjerim dhe ndriçim, kishte ngritje veprash por edhe shkatërrim vlerash.

Mohimi i plotë apo rrezatimi i plotë janë njëlloj të dëmshëm, pasi një rruge, katër dekadëshe, nuk mund të lidhet me një emër të vetëm.

Një rrugë, një rruginë, një rrugicë, mund të ketë një emër; një jetë nuk mund të ketë. Koha për të treguar rrugën e saktë, sidomos për ata që nuk kanë ecur kurrë në të, ka ardhur dhe po shkon.

**(Fund)**



# DUKAGJINËT SIPAS BURIMEVE ARKIVORE

Edhe pse i shkruar vetëm në pesë rreshta tekst, ky është një ndër dokumentet (aktet diplomatike) më të rëndësishme të shekullit XIV për familjet fisnike feudale shqiptare, origjinali i të cilit ruhet në Dubrovnik. Raportet diplomatike me Raguzën dhe pozitat e qendrueshme ekonomike të Dukagjinëve në shek. XIV janë në qendër të vëmendjes. Dëshmi për zhvillimin e një kancelarie shumëgjuhëshe pranë kësaj familje, ngjashëm me familjet e tjera shqiptare dhe evropiane

Prof. dr. Musa AHMETI

Njëra ndër familjet fisnike shqiptare më të fuqishme dhe më të njohura në mesjetë është familja e Dukagjinëve. Për historinë, gjenealogjinë, origjinën dhe shtrirjen e sundimit, marrëdhëniet diplomatike me familjet e tjera fisnike shqiptare dhe me fisnikët fqinjë joshqiptarë: sllavë, grekë, bullgarë, rumunë, etj., si dhe me komunat (shtetet) e kohës, qofshin ato shqiptare, dalmatine, italiane, spanjolle, frënge apo të tjera, gjatë shekujve të mesjetës janë shkruar disa studime, por asnjëherë shteruese. Befason fakti se shumë studiues kopjojnë njëri-tjetrin (këtu duhen theksuar dy apo tre studiues shqiptarë që kanë provuar të shkruajnë për këtë familje fisnike) pa përmendur se kanë shfrytëzuar veprat e mëparshme të botuara apo burimet arkivore origjinale, si dorëshkrime, literaturë mesjetare apo burimetë tjera.

Duke u mbështetur në burimologjinë arkivore, si dorëshkrime, dokumente, dipoma, akte dipomatike, bula papnore apo informacione të tjera të sakta, është i pamohueshëm fakti që kjo familje ishte shumë e fuqishme në shekujt XIV e XV duke zotëruar një territor mjaft të gjërë sundimi, në kohën kur familja e Kastriotëve ende nuk kishte dalë në skenën politike, ushtarake dhe shoqërore të kohës. Natyrisht politika e ndjekur nga Dukagjinasit gjatë epokës skenderbegiane kërkon një studim të specializuar, të thellë, profesional, duke analizuar rrethanat e kohës si dhe duke ballafaquar burimet dokumentare arkivore me literaturën e kohës, duke shmangur tendenciozitetin dhe njëanshmërinë e cila sot shfaqet te amatorët e historisë në forma të ndryshme, deri në skajshmëri ekstreme.

Kësaj radhe nuk kemi për qëllim të debatojmë me të gjithë këta të "ashtuquajtur autorë", por, po botojmë një diplomë (akt diplomatik) origjinale nga Arkivi Historik i Dubrovnikut.

Diploma që po botojmë me këtë rast është e njohur nga studiuesit dhe historianët, por për herë të parë ajo botohet së bashku me faksimile cilësore të cilat specialistët e medievistikës dhe paleografisë së sllavishtes së vjetër mund t'i lexojnë lehtësisht (shih ilustrimet nr. 1 dhe 2). Përveç kësaj botimi është shoqëruar edhe me aparat kritik, përkthim në gjuhën shqipe e transliterime transkriptim të dorëshkrimit të diplomës (akt diplomatik). Logjika e studimit përcjellës, e bazuar në të gjitha këto elemente shkencore mund të ndiqet lehtësisht jo vetëm nga studiuesit, historianët, medievistët, por edhe nga amatorët e interesuar në këtë fushë dhe historidashësit. Ky botim njëherë e mire nxjerr në pah botimet joprofesionale dhe joserioze të bëra nga studiues të ndryshëm, e veçanërisht përkthimet në gjuhën shqipe, të cilat lënë shumë për të dëshiruar, sidomos për pasaktësitë dhe perifrazimet e origjinalit, gjë që e kanë shtrembëruar dhe dëmtuar në masë të madhe vlerën historike të kësaj diplome (akt diplomatik).

Diploma origjinale sot ruhet në Arkivin Historik të Dubrovnikut në Dubrovnik me signaturë P. Nr. IV a 67, pra si diplomëe veçantë (dhe signaturë të vjetër 792), përderisa më parë (deri në fillim të shek. XX) ruhej në kuadër të fondit: Diversa Cancellarie 1387-1389, P. II, 38, dhe këtu si shtesë nr. 27. Kjodiplomë tani është i regjistruar me titullë: "Lekë Dukagjini fton dubrovnikasit që të bëjnë tregti nëpër tokën e tij".





### Përshkrimi fizik i diplomës (akti diplomatik)

Diploma (akti diplomatik) është i shkruar në letër gjysëm karton. Dimensionet e diplomës janë: 19.6cm x 8.9cm ndërsa dimensioent e tekstit janë: 17.7cm x 6cm.

Për herë të parë, kjo diplomë është botuar në vitin 1862. Pas këtij botimi kanë pasuar ribotime të shumta, (shih: Puciq 1862, Mijatoviq 1881, Novakoviq 1912, Sufflay 1918, Shllaku 1940, Burime 1962) po asnjëherë korrekte dhe me gabime e lëshime të ndjeshme.

### Transkriptimi [tejshkronjëzimi] i diplomës

Transkriptimi (tejshkronjëzimi) i diplomës origjinale me signaturë: Wiena 792, ose P. Nr. IV a 67, është shumë i vështirë jo vetëm për studiuesit, medievistët, historianët epaleografët e çirilikës, e sidomos për ata që nuk janë specialistë të paleografisë sllave, asaj çirilike e glagolike, por edhe për ata që kanë përvojë të gjatë në transkriptime të këtij lloj shkrimi. Shkurtesat e shumta dhe grafia e imët dhe në disa raste, shenjat e veçanta të logofetit ose scribes-it, vështirësojnë edhe më shumë transkriptimin. Pra, teksti i diplomës lexohet me vështirësi për shkak të shkurtesave të shumta si dhe gjuhës e drejtshkrimit jo të saktë të përdorur nga logofeti/scribes-i, që ka shkruar këtë diplomë. Ky fakt lë të kuptohet se logofeti/scribesinuk ka qenë sllav, po shqiptar që ka punuar në kancellarinë e familjes Dukagjini, që ka njohur gjuhën sllave si dhe shkrim-leximin e saj. Kjo diplomë që ka karakterin e një dokumenti publik (akti diplomatik) mban në vetvete të gjitha karakteristikat e dokumenteve të kësaj epoke historike.

### Teksti i diplomës

Teksti i diplomës është shkruar në pesë rreshta ngjyrë kafe e cila i ka përballuar një kohe të gjatë tashmë prej 631 vjetëve. Në të djathtë poshtë me laps plumbi është shënuar në fund të shek. XIX: h. si D. Cancellar. 1388-1389, (numri 8 te viti 1388 ka të shënuar numrin 7 që lë të kuptohet se logofeti/scribes-i, e ka shkruar gabimisht vitin, gjë që vërehet edhe nga datimi i diplomës /aktit diplomatik/).

### Vula e diplomës

Në të majtë të diplomës, poshtë tekstit, vërehen gjurmët e vulës prej dylli të kuq, që për fat të keq tani nuk është më! Vula ka qenë e vendosur në anën e pasme (verso) të diplomës. Dimensionet e gjurmës së vulës janë: 1.6 x 1.8 cm. Kurse perimetri është 5.2 cm. (Këto të dhëna na i ka saktësuar dr. Niksha Selmani nga Arkivi i Dubrovnikut, të cilin e falenderojmë publikisht). Siç mund të vërehet në diplomën origjinale, vula ka qenë e tipit të shtypur në letër, sipër së cilës ka qenë një letër e bardhë e hollë e ngjitur nëpërmjet shpimit të letrës bazë (shih ilustrimin 1 dhe 2), ngjashëm me vulat e fisnikëve të tjerë shqiptarë: Balshajve, Topiasve, Spanëve, Muzakëve, Kastriotëve... etj.

### Diploma në verso

Në verso, pjesën e pasme të diplomës, diplomaka të shënuar në dy rreshta një tekst me këtë përmbajtje: "/1/ † Vlastelome ?estenoga /2/ grad Dubrovenika" ndërsa në mes të fjalëve grad () Dubrovnika vërehet se ka qenë e vendosur vula prej dylli të kuq. Në mes të faqes verso është vula e Arkivit Historik të Dubrovnikut nga fundshekulli XIX.

Diploma ka qenë i palosur katër herë: një herë horizontalisht dhe tre herë vertikalisht, gjë që vërehet në ilsutrimin nr. 2. Në pjesën e tretë të thyerjes së palosjes vërehet gjurma e vulës, e cila lë të kuptohet se kjo letër ka qenë e mbyllur me vulë. Diploma është në gjendje të mirë dhe nuk ka pasur nevojë të restaurohet.

### Filigranes

Duke analizuar me kujdes letrën e diplomës, poshtë në të djathtë mund të vërehet një pjesë e filigranes (shenjës së ujit), që është e pamjaftueshme për të kuptuar të gjithë shenjën (figurën) përkatëse të filigranit.

Në vijim po sjellim tanskriptimin e diplomës. Me numrat në kllapa të drejta kemi shënuar fillimin e rreshtit sipas origjinalit të tekstit në diplomë. Kurse në përkthim, në kllapa të vogla, me shkronja të pjerrëta,(italike) kemi shënuar fjalët e origjinalit të tekstit sllavisht, por që i humbin kuptimin fjalisë po të përkthehen fjalë për fjalë. Pra kemi shënuar të dy variantet e mundshme, atëtë përkthimit fjalë për fjalë sipas origjinait dhe përkthimin sipas kuptimit.

### Tranksriptimi i origjinalit në sllavisht:

/1/ † Ode Leke Dukagin i Pavla brat mu vlasteome ?estioga grad Dubrovni -
/2/ ka pišu vera vi moja i moga brat gerdet slobodno po moei zemli ne boite se niša
/3/ a ere e za carinu davaite si zakonenu carinu šo ste i prege davli ineme vlastelome
/4/ koi su prege nastojeki na teme meste bil a inedoga strah se ne boite ere se umirihe
/5/ s tureci i boga vi vesli

**Ne verso:**
/1/ † Vlaste lome ?estenoga
/2/grad Dubrovenika
**Die penultimo Dec. 1387**

# TË DUBROVNIKUT NË SHEKULLIN XIV



**Përkthimi në gjuhën shqipe:**

† Nga Lekë Dukagjini e Pali vëllai i tij.
Fisnikërisë së nderuar të qytetit të Dubrovnikut.
Ju shkruaj në besën time dhe të vëllait tim të kaloni lirisht nëpër tokën time pa iu frikësuar asgjëje dhe për doganë duhet të jepni (paguani, m.a.) sipas ligjit doganën (taksën doganore, m.a.) që ua keni dhënë edhe më parë atyre fisnikëve që më parë kanë banuar (sunduar, m.a.) në këtë vend dhe pa asnjë frikë dhe pa asnjë dyshim, sepse jam pajtuar me turqit dhe në Zotin ju gëzuar (Zoti ju gëzoftë, m.a.).

**Në verso:**
† Fisnikërisë së lartësuar (nderuar, m.a.)
të qytetit të Dubrovnikut
30 dhjetor 1387

**Paraqitja paleografiko-diplomatike e diplomës**

Duke qenë se editimi ynë bëhet sipas kritereve bashkëkohore shkencore, ne po sjellim një studim paleografiko-diplomatik të kësaj diplome mesjetare, përkatësisht të fundit të shek. XIV.

Në fillim të diplomës është i shënuar **invokacioni simbolik,** që në këtë rast na paraqitet në formë të një kryqi të tejzgjatur deri në rreshtin e dytë të tekstit, që është tregues i nënshtrimit të pushtetit real të Dukagjinasve ndaj atij kishtar, duke treguar besnikërinë absolute ndaj kishës.

**Invokacioni verbal,** që përdoret në këtë diplomë, është karakteristikë e shpeshtë e përdorimit në diplomatë tilla të lëshuara nga kancelari sllave. Me këtë, i rritej vlera diplomës (aktit diplomatik) duke dëshiruar që të arrihej qëllimi për destinimin e tij. Në këtë rast, është i shprehur në formën:"në besën time dhe të vëllait tim të kaloni lirisht nëpër tokën time".

Menjëherë në vijim është **intitulacioni** që është i shkurtër fare: "Nga Lekë Dukagjini e Pali, vëllai i tij". Kjo është një shprehje e zakonshme e kohës për fisnikët shqiptarë, të cilët, kur u drejtohen fisnikëve të tjerë apo komunave (shteteve) të kohës, shkruajnë emrin personal të tyre dhe pothuajse çdo herë të shoqëruar edhe nga një person i dytë i familjes, vëllai, xhaxhai, kurshëriri i parë, e në raste të rralla, gruaja ose motra. Në këtë rast, te kjo diplomë, Lekë Dukagjini, që mendohet të jetë i pari me këtë emër, përkrah emrit të tij shënon edhe emrin e të vëllait Palit. Më këtë rast duhet të theksojmë se nuk është fjala për Lekë Dukagjinin e kohës së Skenderbeut, por për të atin e tij, ose ndoshta gjyshin e tij.

Në vijim, Lekë Dukagjini i siguron dubrovnikasit në formën e njohur të së drejtës zakonore shqiptare, se ai është garant për kalimin e tyre nëpër territorin ku ai sundon, me kusht që ata të respektojnë obligimet e tyre, pra të paguajnë doganën. Ky pohim në dukje të parë nuk duket shumë i rëndësishëm, por nëse e studiojmë me kujdes do të vërejmë se është një dëshmi e pakundërshtueshme se familja fisnike feudale e Dukagjinasve ka rrënjë të lashta fisnikërie shqiptare dhe se ata ishin krenarë për këtë gjë.

Kurse **dispozicioni,** si pjesa më e rëndësishme e diplomës (aktit diplomatik), e cila në vete ngërthen objektin moral dhe atë material, që i dedikohet pranuesit, na paraqitet në formën ku Leka në mënyrë bindëse i siguron dubrovnikasit se ata mund të vijnë në territoret që ai sundon: "pa asnjë frikë dhe pa asnjë dyshim, sepse jam pajtuar me turqit", shprehet ai.

Në **ekspozicion (narracion)** janë sqaruar rrethanat aktuale për vendimin e shkrimit të një akti të tillë diplomatik ku Leka pohon: "kaloni lirisht nëpër tokën time pa iu frikësuar asgjëje dhe për doganë duhet të jepni sipas ligjit doganën që ua keni dhënë edhe më parë atyre fisnikëve që më parë kanë sunduar (...) sepse jam pajtuar me turqit". Me sundues të mëparshëm, Lekë Dukagjini nënkupton sunduesit serbë, përkatësisht carin Dushan, gjatë kohës që kishte pushtuar Shqipërinë mesjetare.

Kjo diplomë, (akt diplomatik) nuk ka të shënuar **datën e lëshimit** të saj. Rreth datimit kemi një përshtjellim,që përfundimisht u zgjidh duke shfrytëzuar fondin e dokumenteve origjinale ku ruhej kjo diplomë më herët. Edhe më parë është shënuar data 30 dhjetor 1387, por pa u saktësuar dhe sqaruar se nga është nxjerrë kjo datë. Duke mos pasur datën e lëshimit, të gjithë që janë marrë me këtë diplomë kanë shënuar si datë të lëshimit, datën e pranimit, përkatësisht të regjistrimit si diplomë e pranuar pranë kancelarisë Raguzane, që është data 30 dhjetor 1387. Kjo nuk është data e lëshimit të kësaj diplome nga Lekë Dukagjini, përkatësisht data e shkrimit të diplomës nga logofeti/scribes-i i Lekës. Duke mos qenë në gjendje të saktësojmë datën e lëshimit, edhe ne kemi pranuar si datë të kësaj diplome datën e lartcekur, edhepse të vetëdijshëm se kjo diplomë (akt diplomatik) është shkruar të paktën 15-30 ditë më herët. Në fondin Diversa Cancellariae (1387-1389), vëll. 27, f. 69vtë Arkivit Historik të Dubrovnikut është shënimi i pranimit të letrës së Lekë e Pal Dukagjinit në kancelarinë zyrtare të Raguzës. Shënimi është i treti me radhë, pra kryerreshti i tretë, në fund të faqes dhe ka gjithsej 3 rradhë tekst (shih ilustrimin nr. 3) me këtë përmbajtje (transkriptimi në latinisht): "Ista littera sclavica fuit hic posita, de mandato domini rectoris et consilii que continet quod merchatores Ragusini possint ire securi per terrenum dominorum Leche et Pauli Ducadini ut patet in littera". Përkthimi në shqip i këtij teksti është: "Kjo letër sklavike (sic! lexo: çirilike) u depozitua me urdhër të z. rektor dhe me këshillën që përmban që tregtarët e Raguzës mund të lëvizin me siguri në territoret e zotërinjve Lekë e Pal Dukadini (sic! lexo: Dukagjini, në origjinal është: Dukadini), siç shënohet në letër". Nga diploma që po botojmë, pohohet se: "me rekomandim të rektorit po rregjistrojmë letrën e depozituar". Ne kemi konsultuar edhe diploma të tjera në sllavisht të familjes Dukagjini që ruhen në Arkivin Historik të Dubrovnikut, po nuk kemi arritur të nxjerrim informacione të sakta në lidhje me këtë çështje.

E pazbardhur mbetet edhe çështja e **autorit të shkrimit të diplomës** - logofetit/scribes-it i cili nuk shënon në fund emrin e tij, sikurse nuk ka shënuar as datën e **vendin e lëshimit.** Pra, ne nuk kemi njohuri se në cilin qytet apo pjesë të sundimit të Lekë Dukagjinit është lëshuar kjo diplomë.

Kësaj diplome i mungon edhe **elementi i përforcimit,** që është i zakonshëm pothuajse në të gjitha diplomat e tjera të kësaj periudhe në gjuhën sllave që njohim deri me sot.

Përveç elementeve të përmendura, këtij akti diplomatik i mungojnë edhe disa pjesë standarte apo klishe, të cilat i ndeshim në diploma të ngjashme nga e njëjta periudhë. Këto mungesa nuk e zvogëlojnë rëndësinë dhe autenticitetin e kësaj diplome.

**Tranksriptimi i origjinalit në sllavisht:**

/1/ † Ode Leke Dukagin i Pavla brat mu vlasteome čestioga grad Dubrovni -
/2/ ka pišu vera vi moja i moga brat gerdet slobodno po moei zemli ne boite se niša
/3/ a ere e za carinu davaite si zakonenu carinu šo ste i prege davli ineme vlastelome
/4/ koi su prege nastojeki na teme meste bil a inedoga strah se ne boite ere se umirihe
/5/ s tureci i boga vi vesli

**Ne verso:**

/1/ † Vlaste lome čestenoga
/2/ grad Dubrovenika
Die penultimo Dec. 1387

**Përkthimi në gjuhën shqipe:**

†***Nga Lekë Dukagjini e Pali vëllai i tij.***
Fisnikërisë së nderuar të qytetit të Dubrovnikut.
Ju shkruaj në besimin tim dhe të vëllai tim të kaloni lirisht nëpër tokën time pa u frikësuar asgjëje dhe për doganë duhet të jipni (*paguani, m.a.*) sipas ligjit doganën (*taksën doganore, m.a.*) që e keni dhënë edhe më parë atyre fisnikëve që më parë kanë sunduar (*banuar, m.a.*) në këtë vend dhe pa asnjë frikë dhe pa asnjë dyshim sepse jam pajtuar me Turqit dhe Zotin ju gëzuar (*Zoti ju gëzoftë, m.a.*).

**Në verso:**

†*Fisnikërisë së lartësuar (*nderuar, m.a.*) të qytetit të Dubrovnikut*
*30 dhjetor 1387*

Sipas burimeve arkivore që ruhen në Arkivin Historik të Dubrovnikut, familja Dukagjini përmendet për herë të parë në histori në shek. IX. Natyrisht që ky burim duhet studiuar, verifikuar dhe ballafaquar edhe me burime e literaturë tjetër për të vërtetuar saktësinë e tij. Kjo familje, si të gjitha familjet fisnike feudale shqiptare kishte ngritjet e rëniet e saj. Poashtu kjo familje gjithnjë sipas burimeve të shkruara arkivore është me rrënjë të mirëfillta shqiptare. Ajo ka luftuar kundër armiqve e pushtuesve të huaj bizantinë, sllavë e osmanë, por ka bërë edhe luftëra lokale kundër feudalëve shqiptarë, për zgjerim territoresh, për rritje ndikimi apo edhe për të "ruajtur nderin" siç ishte rasti me Lekë Zaharinë. Ajo ka pasur marrëdhënie diplomatike me shumë komuna(shtete) e njësi të tjera politike të kohës në Europë,Dalmaci e me fisnikë shqiptarësi dhe me fqinjëtë tjerë jo-shqiptarë. Ajo ka njohur në më shumë se një rast vasalitetin e sundimtarëve të huaj, si të Republikës sëVenedikut, PerandorisëOsmane, mbretit Alfonsi V etj., ngjashëm me fisnikët e tjerë shqiptarë. Dukagjinasit ishin besimtarë të devotshëm, por kemi rastin kur kërcënohen me çkishërim nga papa me rastin e konfliktit me Gj. K. Skënderbeun. Ata patën më shumë se një pinjoll që pranoi fenë islame, dhe që u ngritën në hierakinë sunduese të Perandorisë Osmane, ashtu si shumë fisnikë të tjerë shqiptarë, si p.sh. Gjergj Kastrioti Skenderbeu, nipi i tij Hamzai ose Ballaban Pasha, ose Topiasit, Spanët, Muzakajt etj. Ata lanë gjurmë të pashlyeshmenë historinë tonë kombëtare, sidomos me "Kanunin e Lekë Dukagjinit", i cili bashkë me kanunet e tjera si p.sh. "Kanunin e Skenderbeut", përbëjnë një kontribut të paçmueshëm për të drejtën zakonore, por edhe të drejtën në përgjithësi në trojet shqiptare.

## Nisin përgatitjet për takimin Trump - Putin

UASHINGTON, 25 QERSHOR - Këshilltari për siguri kombëtare i Shteteve të Bashkuara, John Bolton, nisi të hënën një turne në Evropë. Ai pritet t'i takojë aleatët amerikanë në Londër dhe Romë, përpara se të udhëtojë drejt Rusisë, më 27 qershor. Një zëdhënës i Kremlinit ka thënë, ditë më parë, se Boltoni do të diskutojë me zyrtarët rusë mundësitë për takimin e presidentit amerikan, Donald Trump, me homologun rus Vladimir Putin.
Ministria e Jashtme e Rusisë tha se Boltoni do të takojë ministrin Sergei Lavrov gjatë vizitës në Moskë. Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, tha në fundjavë se Trumpi, me gjasë, do të takojë Putinin "në një të ardhme jo shumë të largët".
Lokacioni i takimit të tillë nuk është zgjedhur, edhe pse zyrtarët kanë thënë se ai mund të zhvillohet në Vjenë.



# Erdogani, fitues i zgjedhjeve presidenciale në Turqi

Rexhep Tajip Erdogan në zgjedhjet presidenciale të së dielës ka mundur rivalin më të afërt në raundin e parë, duke fituar më shumë se 50 për qind të votave. Dalja në zgjedhjet parlamentare dhe ato presidenciale ka qenë 87 për qind



ANKARA, 25 QERSHOR - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, shpalli fitore në zgjedhjet presidenciale të së dielës dhe tha se aleanca e udhëhequr nga Partia e tij për Drejtësi dhe Zhvillim (AKP) ka fituar shumicën parlamentare. Erdogani ka mundur rivalin e tij më të afërt në raundin e parë, duke fituar më shumë se 50 për qind të votave, tha udhëheqësi i Komitetit Suprem të Zgjedhjeve (YSK), Sadi Guven, pa dhënë shifra të sakta. Guven tha se 99.1 për qind të votave janë numëruar. Sipas tij, votat e mbetura nuk do të ndikojnë në rizgjedhjen e Erdoganit.
YSK pritet t'i publikojë rezultatet përfundimtare në 10 apo 11 ditët në vijim. Në po të njëjtën kohë, agjencia shtetërore e lajmeve Anadolu raportoi se me gati të gjitha votat e numëruara, Erdogani fitoi 53 % të tyre, ndërsa rivali i tij më i afërt, Muharrem Ince, 31 %. Sipas burimit të njëjtë, AKP-ja kryeson me 43 % të votave, ndërsa opozita kryesore, Partia Popullore Republikane, ka 23 %. Opozita, megjithatë, i kundërshton këto shifra, duke thënë se shumë vota ende nuk janë numëruar.
Sipas rezultateve jozyrtare, partia pro-kurde HDP pritet ta kalojë pragun prej 10 % të votave dhe të hyjë në parlament.
Të dielën në Turqi u mbajtën edhe zgjedhjet presidenciale dhe ato parlamentare.
Këto zgjedhje fillimisht kanë qenë të parapara për nëntor të vitit 2019, por janë sjellë më herët nga Erdogani. Dalja në zgjedhjet parlamentare dhe ato presidenciale ka qenë 87 për qind, kanë thënë zyrtarët.
"Kombi më ka dhënë besimin dhe përgjegjësinë e presidencës dhe detyrës ekzekutive", tha Erdogani gjatë një fjalimi televiziv nga Stambolli.
"Mesazhi është i qartë", shtoi ai.
"Me dalje gati 90 për qind, Turqia i ka treguar gjithë botës mësime për demokracinë".
"Dëshiroj t'i falënderoj të gjithë qytetarët, pavarësisht se nga cila parti janë, që kanë dalë në zgjedhje për të shfrytëzuar të drejtën e tyre demokratike", tha 64 vjeçi.
Presidenti rus Vladimir Putin ka përgëzuar Erdoganin për rizgjedhjen e tij, duke thënë se rezultatet kanë treguar "autoritet të madh politik" dhe mbështetje masive.
Turqia mbetet në gjendje të jashtëzakonshme, e cila është vënë që pas përpjekjes për grusht shtetit atje, në korrik të vitit 2016.
Zgjedhjet u mbajtën nën masa të rrepta të sigurisë. Vetëm në Stamboll, mbi 38 mijë policë kanë qenë në detyrë.
Shqetësime për kërcënimin e mundshëm të votuesve ka pasur sidomos në zonat juglindore të Turqisë, ku vota kurde ka qenë e rëndësishme për rezultatin.
Aktivistët e të drejtave të njeriut po ashtu kanë thënë se mediet nuk kanë qenë të lira për të raportuar për të gjitha palët.
Erdogani ka dominuar politikën turke për më shumë se 15 vjet, fillimisht si kryeminister dhe nga viti 2014 si president. Sipas grupeve monitoruese, nën sundimin e Erdoganit, Turqia është bërë vendi që ka burgosur më së shumti gazetarë në botë.
Kandidati presidencial i opozitës në Turqi, Muharrem Ince pranoi humbjen të hënën në zgjedhje që i cilësoi "të padrejta" dhe paralajmëroi se vendi po hynte në një regjim të rrezikshëm nën kontrollin e një njeriu të vetëm.
Edhe disa udhëheqës të BE-së komentuan pasi presidenti Rexhep Tajip Erdogan deklaroi fitoren e tij dhe të aleancës së udhëhequr nga partia e tij AKP.
Në një konferencë me gazetarë, Ince i partisë CHP i bëri thirrje presidentit Erdogan që sot e tutje të mos veprojë si kryetar i AKP-së, por president i 85 milionë turqve. "Këto zgjedhje do të kenë ndikim të thellë te demokracia jonë si dhe në jetën tonë në të ardhmen. Këto zgjedhje që nga mënyra se si u shpallën, te shpallja e rezultateve, në tërësinë e tyre, kanë qenë të padrejta", tha ai.
Ince shtoi se regjimi që merr pushtetin sot është një rrezik i madh për Turqinë, pasi është një regjim ku pushteti është përqendruar te një person.

## Ish-shefit të NATO-s i ndalohet hyrja në ShBA

UASHINGTON, 25 QERSHOR - Ish-shefit të diplomacisë evropiane, Javier Solana, njëkohësisht ish-sekretar i përgjithshëm i NATO-s, i është ndaluar hyrja në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Lajmin e përcjell "New York Times", që si arsye për këtë ndalim citon një vizitë të tij në Iran në vitin 2013.
Solanës, një prej politikanëve më të rëndësishëm të BE-së, i është mohuar autorizimi elektronik për ta shkelur në tokën amerikane, e tani, siç thotë edhe vetë, do të aplikojë për vizë.
75 vjeçi e konsideron këtë akt për çdo rast, më shumë burokratik sesa politik. Në vitin 2016, administrata "Obama", në përgjigje të kufizimeve të vendosura nga Kongresi i ashpërsoi rregullat e hyrjes për qytetarët e 38 vendeve, të cilët kishin udhëtuar drejt Iranit, Irakut, Sudanit apo Sirisë pas 1 marsit të vitit 2011.
Solana ishte në Republikën Islamike në vitin 2013, si i ftuar për betimin e presidentit Hassan Rouhani, ndërkohë që atëherë nuk mbante ndonjë post zyrtar.



E rrallë

# Voton me fustanin e nusërisë



Një nuse në qytetin Tekirdag të Turqisë para ceremonisë së dasmës ka shkuar për të votuar me fustanin e nusërisë në zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare që u zhvilluan të dielën, raporton Anadolu Agency (AA). Nusja Zeynep Giriklioglu ka tërhequr vëmendjen e qytetarëve pasi ajo para ceremonisë së dasmës ka mbërritur në shkollën e mesme të hotelerisë dhe turizmit në qytetin Tekirdaq për të votuar.

## BARSOLETA E DITËS



**Infermierja: I ke marrë barnat, fashat, shiringat dhe infuzionet?**
**Pacienti: Po.**
**Infermierja: Jastëkun dhe çarçafin?**
**Pacienti: Po.**
**Infermierja: Po ky personi me ju, kush është?**
**Pacienti: Ky është mjeku. E kam sjell nëse nuk keni.**

FOTO E DITES



Dielli duke perënduar në qytetin e Pejës. / Foto: Granit Dinaj/

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Vetem gjate vikendit**
**në ora 15:00**

### "AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlet Johansson, Tom Holland, Zoe Soldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo






**Në ora 18:00**

### "ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.
**Regjia:** Wes Anderson

**Në ora 16:00 dhe 20:00**

### "DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

**Rolet:** Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesy, etj.
**Regjia:** David Leitch

**Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.**







**Në ora 22:00**

### "I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

**Rolet:** Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.
**Regjia:** Abby Kohn & Marc Silverstein

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

E jashtëzakonshme

# Ish-bashkiaku ia lë 4 milionë euro trashëgimi qytezës që drejtoi



Carlo Nicoli (Dc) ka lënë si trashëgimi katër milionë euro në Bashkinë e Fornovos San Giovanni, qendra e pesë mijë banorëve të Bergamos së Ulët, të cilën e kishte administruar në vitin 1962 dhe 1975. Kjo u bë me dije nga kryetari aktual, Gian Carlo Piana, gjatë këshillit të fundit bashkiak të qytetit. Ish-kryetari i bashkisë vdiq në moshën 85-vjeçare dhe i la të gjitha pasuritë e tij në qytet.



**DASHI**
Dita e sotme do të jetë pa ndonjë emocion të veçantë. Do të keni mjaft kohë të lirë në dispozicion.



**DEMI**
Në mendjen tuaj vazhdon një mendim fiks që diku keni gabuar me një mik të ngushtë. U bë kohë që nuk flisni.



**BINJAKËT**
Edhe pse të dyzuar në shumë çaste, sot do të arrini të shpëtoni situata mjaft delikate.



**GAFORRJA**
Keni vendosur të mos pajtoheni me disa ngjarje që për ju kanë lënë shije të keqe. Do të ankoheni me zë të lartë për këtë fakt.



**LUANI**
Ndjenjat tuaja karshi një personi kanë kohë që kanë filluar të lëkunden. Tashmë po jetoni dy realitete të ndryshme.



**VIRGJËRESHA**
Çështjet financiare janë ato që ju shqetësojnë sot. Edhe pse ndiheni të stabilizuar, e ardhmja ju tremb.



**PESHORJA**
Kanë afruar tek ju sot mjaft optimizëm dhe buzëqeshje. Do të mundoheni t'i shpërbleni këta persona.



**AKREPI**
Ditët në vazhdim janë ditë relaksi dhe ju mezi i kishit pritur. E gjithë ngarkesa e punës do të zhduket si me magji.



**SHIGJETARI**
Një mik i juaji do t'ju hapë sytë lidhur me një situatë të caktuar. Nuk e mendonit që mund të ishte kaq serioz.



**BRICJAPI**
Nëse keni vendosur të ndryshoni gjërat për ju dhe familjen tuaj duhet ta ndani mendjen mirë. Vendimi është shumë i rëndësishëm.



**UJORI**
Në këtë periudhe të gjithë ju që jeni në punë apo në shkollë nuk keni fare interes për të punuar. Çdo gjë ju çon larg në mendime.



**PESHQIT**
Sot do të jetë ditë mjaft intensive në ambientin e punës. Nëse keni lënë gjëra pa zgjidhur, mund t'ju mbivendosen.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com
Montimi
Servisim
Porosi

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

| DENMARK - FRANCE | X2 | AUSTRALIA - PERU | 1 | NIGERIA - ARGENTINA | 2 |
|---|---|---|---|---|---|

# Uruguai tregon fuqinë, duke poshtëruar Rusinë

Uruguai është kualifikuar me pikë maksimale në 18-n e finales në Kupën e Botës, kurse në vendin e dytë të Grupit A ka përfunduar mikpritësi i këtij Botërori, Rusia me gjashtë pikë. Mohamed Salahi ësshtë përshëndetur në mënyrën më të keqe nga "Rusi 2018". Pasi pësoi humbje edhe në ndeshjen e fundit nga Arabia Saudite (2-1)

SAMARA, 25 QERSHOR - Tri ndeshje, zero gola të pësuar. Uruguai edhe një herë ka zhvilluar një ndeshje të përsosur në prapavijë dhe kësaj radhe për të shënuar e kishte Luis Suarez, i cili është bërë uruguaiani që ka shënuar më shumë gola në Kupat e Botës, me shtatë të tillë në fitoren 3-0 ndaj Rusisë. Goli i Laxalt pak përpara se të përfundonte pjesa e parë vulosi fitoren e amerikanojugorëve, që e mbyllin fazën e grupeve në krye dhe presin tani njërin mes Spanjës dhe Portugalisë. Në fund të takimit ishte edhe Cavani ai që trefishoi rezultatin duke fundosur ende më shumë vendësit. Ndërkohë Egjipti dhe Arabia Saudite largohen nga Kupa e Botës me janë fitore 2-1 të Arabisë pas golit të sekondave të fundit. Skuadrat e kishin siguruar largimin sido që të ishte rezultati në fund të ndeshjes dhe dukej se një barazim do t'i kënaqte të dyja palët që deri në atë moment nuk kishin asnjë pikë, por goli i Dawsarit ua dha fitoren arabëve. Ndeshja nisi shumë mirë dhe Uruguai gjeti menjëherë golin e avantazhit. Rusët nuk u pajtuan me atë situatë dhe sulmuan për të barazuar, por një karton i kuq i preu krahët vendësve. Mohamed Salah largohet me një tjetër gol nga ky kompeticion, këtë herë me një perlë tipike. Pasi merr një top të gjatë nga mbrojtja, ylli i Liverpoolit sheh daljen e portierit dhe vendos të lëshojë një parabolë të përsosur me topin që përfundon në rrjetë. Ndërkohë Arabia barazon rezultatin me një penallti në minutën e pestë shtesë të pjesës së parë, pasi kishte humbur një penallti disa minuta më parë. Në pjesën e dytë ndeshja ishte e barabartë, por në sekondat e fundit të ndeshjes arabët shënojnë golin e fitores. Një tjetër fakt historik është paraqitja e portierit të Egjiptit, El Hadary, portieri më i vjetër që ka shkelur në një Kupë Bote. Në pjesën e parë ai ka pritur edhe një penallti.



**GRUPI A**

| | |
|---|---|
| Arabia Saudite - Egjipti | 2-1 |
| Uruguai - Rusia | 3-0 |

**TABELA**

| | |
|---|---|
| 1. Uruguai | 9 pikë |
| 2. Rusia | 6 |
| 3. Arabia Saudite | 3 |
| 4. Egjipti | 0 |

## Argjentina me çdo kusht kërkon kualifikimin

Argjentina e Lionel Messit kërkon me çdo kusht kualifikimin për 1/8 e finales së Kupës së Botës. Kjo kombëtare është kritikuar shumë pas dy paraqitjeve dëshpëruese në ndeshjet e para, por ata kanë edhe një rast që me fitore ndaj Nigerisë të kualifikohen tutje. Atmosfera jo e mirë në skuadër dhe mosbesimi në trajneri Jorge Sampaoli mund të ndikojnë edhe me paraqitje jo të mirë në ndeshjen vendimtare. Në anën tjetër, Nigeria, që pozicionohet e dyta me një barazim ndaj argjentinasve, do ta siguronte kualifikimin, derisa edhe Islanda që luan ndaj Kroacisë është ende në garë për kualifikimin, por fitorja ndaj kroatëve duket mision i pamundur. Dy ndeshjet e tjera që zhvillohen të martën janë nga Grupi C, ku Franca e ka siguruar kualifikimin, por nuk pritet të lejojë befasi për ta humbur pozitën e parë në grup nga Danimarka, e cila ka grumbulluar katër pikë, por me humbje dhe me fitore të Australisë ndaj Perusë, eliminimi mund të ndodhë. Peruja ka pësuar dy humbje në dy ndeshjet e para, kurse në ndeshjen e fundit do të kërkojë që me rezultat pozitiv të përshëndetet nga ky Botëror.

**GRUPI C**

16:00 Australia - Peruja
16:00 Danimarka - Franca

**TABELA**

| | |
|---|---|
| 1. Franca | 6 pikë |
| 2. Danimarka | 4 |
| 3. Australia | 1 |
| 4. Peruja | 0 |

**GRUPI D**

20:00 Islanda - Kroacia
20:00 Nigeria - Argjentina

**TABELA**

| | |
|---|---|
| 1. Kroacia | 6 pikë |
| 2. Nigeria | 3 |
| 3. Islanda | 1 |
| 4. Argjentina | 1 |

## SHKURT

### FIBA nuk ndryshon datat për ndeshjet kualifikuese të Kosovës

Përfaqësuesja e Kosovës do t'i luajë dy ndeshjet kualifikuese për Botërorin "Kina 2019", sipas orarit të paraparë. Kosova më 28 qershor do të përballet me Hungarinë, kurse më 1 korrik do të ballafaqohet me Poloninë. Të dyja ndeshjet Kosova do t'i luajë me fillim nga ora 20:30 në palestrën e vogël të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Pas ngjarjes tragjike që ka ndodhur mëngjesin e së shtunës, ku e ka humbur jetën basketbollisti Gazmend Sinani dhe janë lënduar tre basketbollistë të tjerë, Fisnik e Granit Rugova, Altin Morina dhe fizioterapeuti Kujtim Shala, Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) kishte kërkuar në FIBA që ndeshjet të mos zhvillohen.

### Notarët përfundojnë garat në "Tarragona 2018"

Notarët e Kosovës kanë përfunduar garat në Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018". Fjorda Shabani, Dren Ukimeraj dhe Dasar Xhambazi përfunduan kryesisht në pozitat e fundit, por që mosha e tyre e re (13-16 vjeçare) jep shpresë për rezultate më të mira në të ardhmen. Fjorda Shabani, në 50 metra stil të lirë, pati kohën 28.49 sekonda. Dren Ukimeraj në 50 metra stil i lirë pati kohën 26.09 sekonda, ndërsa Dasar Xhambazi në stilin bretkosë pati kohën 32.11 sekonda.

### Boksierët e Kosovës sot dhe nesër garojnë në "Tarragona 2018"

Kombëtarja e Kosovës në boks ka mësuar shortin para garave në Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018". Në bazë të shortit të hedhur, boksierët i nisin garat sot (e martë). Besfort Merlaku në raundin e parë takohet me italianin Raffaele di Serio në kategorinë -56 kilogramë. Violant Sylejmani u kualifikua pa luftë, ndërsa në çerekfinale takohet me francezin Sofiane Ouminha në kategorinë -60 kilogramë. Patriot Behrami lufton me grekun Alexandro Tsanikidis, në kategorinë deri -64 kg, ndërsa Dielli Vranoci do të përballet me Francesco Magri të Italisë, në kategorinë -69 kg. Behrami, Vranoci dhe Merlaku garojnë sot nga ora 16:00, kurse Sylejmani të mërkurën.

### FBK-ja pensionon numrin 15 për nder të Gazmend Sinanit

Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu, përmes një postimi në "Facebook" ka konfirmuar se është marrë vendimi që fanella me numër 15 e kombëtares së Kosovës e veshur nga Gazmend Sinani do të pensionohet. "Ishe i pari që veshe fanellën e Kombëtares me numër 15. Atë numër e kërkove prapë pardje. Atë numër do ta mbash përgjithmonë vetëm ti, Gazi ynë. Numri 15 i Kombëtares sonë do të pensionohet me emrin tënd, Gazmend Sinani. Ishe plot jetë Gaz. Ike nga kjo jetë papritmas, por do të mbetesh gjithë në zemrat e të gjithë atyre që të njohën", ka shkruar Fetahu. Gazmend Sinani ka vdekur pas një aksidenti të rëndë në trafik, me ç'rast edhe katër të tjerë ishin lënduar, tre basketbollistët Granit e Fisnik Rugova, Altin Morina dhe fizioterapeuti Kujtim Shala.

### Brajshori e katërta dhe e pesta në disiplinat shtytje dhe shkëputje

Peshëngritësja Leonora Brajshori për pak nuk arriti ta fitojë medaljen e bronztë në Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018". Garuesja nga Kosova doli e katërta nga gjashtë pjesëmarrëse, në disiplinën shtytje, kategoria -53 kg. Ajo ngriti 62 kilogramë, derisa në dy tentimet e tjera nga 62 dhe 66 kilogramë nuk pati sukses. Në disiplinën shkëputje, Leonora nga tri tentime ngriti 76 dhe 80 kilogramë, duke u renditur e pesta. Leonora ishte garuesja e vetme që përfaqësoi sportin e peshëngritjes në "Tarragona 2018".

## Vetteli: Mund të kishim një rezultat më të mirë në Francë



BERLIN, 25 QERSHOR - Piloti i Ferrarit, Sebastin Vettel, është shprehur i zhgënjyer me paraqitjen në Francë, pasi është i bindur se ka mundur të ketë rezultat më të mirë. "Ishte një gabim nga ana ime, ndaj mendoj se penaliteti nga ana e komisarëve të garës ishte i drejtë. Për fat, ata pesë sekonda penalitet nuk ndikuan shumë në renditjen përfundimtare. Më vjen keq, pasi prisha garën time dhe atë të Bottas. Mund të kishim arritur një rezultat të mirë në Francë", ka thënë Sebastian Vetteli. Më tej, piloti gjerman i "kokëkuqes" ka shtuar se: "Nuk e di nëse do të kisha pasur mundësinë për ta fituar garën po të mos kishte ndodhur aksidenti, por di që kishim një makinë të mirë dhe mund ta kapnim podiumin. Nisja e garës ishte e mirë, por nuk pata më shumë hapësirë. U përpoqa ta evitoja kontaktin me Bottasin, por nuk arrita. Tani mendoj për garën e radhës".

# FIFA dënon Xhakën dhe Shaqirin me të holla

CYRIH, 25 QERSHOR - Komisioni Disiplinor i FIFA-s i ka dënuar dy futbollistët shqiptarë të Zvicrës, Xherdan Shaqirin dhe Granit Xhakën si dhe kapitenin zviceran Stephan Lichsteiner, me të holla. Shaqiri dhe Xhaka janë dënuar me nga 10 mijë franga, kurse mbrojtësi Lichsteineri është dënuar me 5 000 franga. Pavarësisht prej këtij dënimi, ky është një lajm i mirë për trajnerin e Zvicrës, Vladimir Petkoviq, i cili mund të llogarisë në shërbimet e lojtarëve më të mirë për ndeshjen e radhës dhe të fundit në grup ndaj Kosta Rikës.



Federata e Serbisë pas ndeshjes ishte ankuar për festimin me shqiponjë që bënë dy futbollistët Granit Xhaka dhe Xherdan Shaqiri pas shënimit të golave, por FIFA nuk i ka dënuar me ndeshje moslojë. "Ky gjest ishte për njerëzit që gjithmonë me mbështetën", kishte deklaruar Xhaka pas ndeshjes. FIFA e ka dënuar Federatën e Futbollit të Serbisë me 54 mijë franga, kurse kryetari i kësaj federate, Slavisa Kokeza dhe trajneri Mladen Krstajiq janë dënuar me nga 5 000 franga.

Zvicra, që ka katër pikë pas barazimit me Brazilin dhe fitores me Serbinë, do ta luajë ndeshjen e fundit të grupit me Kosta Rikën dhe me një barazim do të kualifikohet në 1/8 e finales.

# Fati i hidhur i futbollistit Son, nga Botërori i Rusisë në ushtri

SEUL, 25 QERSHOR - Goli kundër Meksikës nuk i mjaftoi Koresë së Jugut për ta evituar eliminimin nga Botërori i Rusisë, ndërkohë që dëshpëroi shumë edhe autorin e tij, Son Heung Min. Futbollisti i Tottenhamit është i shqetësuar sepse rrezikon ta kryejë shërbimin ushtarak në Seul me një pagë prej 100 eurosh në muaj, ndërkohë që te Hotspurs ai përfiton 360 mijë, sigurisht ka ende dy shanse ta evitojë këtë, por gjithçka varet nga Tottenhami, e sidomos nga rezultatet e përfaqësueses së Koresë së Jugut. Kjo situatë ishte e qartë që përpara fillimit të Botërorit dhe arritja në çerekfinale është diçka shumë e rëndësishme për Son. Sipas ligjit në Korenë e Jugut, kryerja e shërbimit ushtarak është e detyrueshme për meshkujt nën moshën 28 vjeç dhe nëse Son do



